
BULETIN INFORMATIV

SHTATOR 2025

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Shtator, 2025

Përmbajtje

Aktivitete madhore	7
U zhvillua mbledhja treditore e Redaksisë Qendrore për Enciklopedinë Shqiptare	8
Nisi punimet Kongresi European i Bioteknologjisë 2025	10
Mbylli punimet Kongresi European i Bioteknologjisë	14
Presidenti i Shoqatës Europiane të Rrjetit Tematik të Bioteknologjisë (EBTNA) i ka dërguar letër mirënjohjeje kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi për mbështetjen dhe kontributin e çmuar në organizimin e Kongresit European të Bioteknologjisë 2025 në Tiranë	17
Çel punimet Kongresi i 5-të Ndërkombëtar NanoBalkan (NB2025)	18
Kryeministri z. Edi Rama përshëndet Kongresin e 5-të Ndërkombëtar NanoBalkan (NB2025)	24
Skënder Gjinushi në konferencën shkencore ndërkombëtare “Qytetet pas tranzicionit në vendet postkomuniste”	27
Mbledhje të komisioneve të përhershme të ASHSH	29
U zhvillua mbledhja e Komisionit të Përhershëm të Arteve	30
U mbajt referati me temën “Vota e diasporës, eksperiencia ndërkombëtare dhe modeli shqiptar” nga dr. Ilirjana Nano	31
Aktivitete	33
U mbajt takimi dyditor me temën: “Kontributi i diasporës shkencore për integrimin në hapësirën europiane të kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë në trojet shqiptare”	34
U mbajt forumi akademik/workshop me temën “Tektonika aktive dhe burimet sizmike për modelimin sizmotektonik në Shqipëri”	38
Mbyllen punimet e Kongresit të 13-të të Studimeve të Europës Juglindore në Shkup	41

U zhvillua konferenca shkencore me temën "Identitete religjioze në trojet shqiptare nga Mesjeta e Vonë deri ne rënien e Perandorisë Osmane"	47
Kronikë për tryezën shkencore “ Alfabetizime dhe kundrime të reja në albanologji” .	49
Filloi punimet Kongresi i 13-të i Studimeve të Europës Juglindore në Shkup	53
Nisi shkolla ndërkombëtare e trajnimit me temën "Nxitja e biosipërmarrjes në bioteknologji”	54
Vijon shkolla ndërkombëtare e trajnimit me temën "Nxitja e biosipërmarrjes në bioteknologji”	56
U përmbyll me sukses shkolla ndërkombëtare e trajnimit	57
Ditë informimi mbi programet e projekteve kombëtare	59
Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare	61
Akademik Gëzim Hoxha merr pjesë në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare të Studimeve Ballkanike në Universitetin Sllav të Baku-së, Azerbajxhan	62
Studiuesja e Qendrës së Studimit të Arteve, dr. Anxhela Çikopano, mbajti diskutimin publik: "Realitete artistike: një film për komunizmin në Shqipërinë jo-komuniste"	65
Prof. asoc. dr. Roven Vata Mikeli, mori pjesë në Seminarin XIX Ndërkombëtar të Albanologjisë & Panairi Mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor me temë bosht: “Dialogu kulturor mes letërsisë shqipe dhe asaj botërore”	66
Prof. asoc. dr. Roven Vata Mikeli, mori pjesë në Konferencën Shkencore “Dritëhije” IV.....	68
Prof. as. dr. Roven Vata Mikeli, mori pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Çështje të gjuhës, letërsisë dhe përkthimit letrar”	71
Prof. as. dr. Evalda Paci, mori pjesë në konferencën shkencore “Transformimet dhe zhvillimi i qendrave urbane në trevat shqiptare gjatë Antikitetit të vonë dhe Mesjetës”	73
Prof. as. dr. Evalda Paci, mori pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare me tematikë “Çështje të gjuhës, letërsisë dhe përkthimit letrar”	74
Marrëveshje bashkëpunimi	75
U nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Shoqatës Europiane të Rrjetit Tematik të Bioteknologjisë (EBTNA) ...	76

Takime.....	78
Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi pret në një vizitë zyrtare ambasadorin e Spanjës në Shqipëri z. Gabriel Cremades Ventura.....	79
Sopranoja e shquar me famë botërore, Ermonela Jaho, merr diplomën si “Anëtare e jashtme” e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë	81
Akademik Shaban Sinani nderohet me çmimin prestigjioz “Sami Frashëri” nga Bashkia e Belshit	85
Të reja	86
Zbulohet një varr monumental i periudhës romake në fshatin Strikcan të Bulqizës...	87
Një studim gjithëpërfshirës mbi gatishmërinë teknologjike në sektorin e mikpritjes shqiptare sapo është publikuar në revistën shkencore ndërkombëtare Tourism and Hospitality (MDPI), e renditur me faktor impakti 3.7, ndër më të lartët në fushën e turizmit dhe mikpritjes.....	89
Revista “Studime për artin”, organi shkencor i Qendrës së Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, është indeksuar në Central and Eastern European Online Library (CEEOL)	91
Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore – Një udhëtim i gjallë nëpër kohë	92
In memoriam.....	94
Akademia e Shkencave kujton me nderim në 115-vjetorin e lindjes akademikun Aleks Buda.....	95
Akademia e Shkencave kujton me nderim akademik Odhise Paskalin.....	97
Pashko Vasa, dy shekuj më vonë	99
Akademia e Shkencave kujton me nderim akademik Mahir Domin	101
I trishtë lajmi për ndarjen nga jeta të mjeshtrit të kinematografisë shqiptare, “Nderi i Kombit” Dhimitër Anagnosti!	104
Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Vasil S. Tole, dhe kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike, akademik Gëzim Hoxha, bëjnë homazhe në nderim të regjisorit të shquar, personalitetit të kulturës shqiptare Dhimitër Anagnosti.....	106
Ndahet nga jeta dr. Agim Bido, studiues i shquar i etnografisë shqiptare.....	107
U nda nga jeta prof. dr. Hëna Pasho.....	109

Ndahet nga jeta profesor Mina Naqo, figurë e shquar e matematikës shqiptare dhe personalitet me kontribute të vyera në arsimin dhe shkencën kombëtare.....	112
Ndahet nga jeta aktori i kinemasë e teatrit, pedagogu, dramaturgu e regjisor z. Enver Petrovci	114

Aktivitete madhore

U zhvillua mbledhja treditore e Redaksisë Qendrore për Enciklopedinë Shqiptare

Redaksia Qendrore në bashkëpunim me Qendrën e Botimeve Enciklopedike Albanologjike (QBEA), pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në datat 25 -27 shtator 2025 mbajtën takimin për miratimin e fjalësit të projektit madhor “Enciklopedia Shqiptare”.

Takimet u zhvilluan në sallën “Akademikët” pranë Akademisë së Shkencave me drejtimin e kryeredaktorit të veprës akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe zëvendëskryeredaktorit akad. Mehmet Kraja, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.



Morën pjesë: akad. Vasil Tole zëvendëskryetar i ASHSH-së; akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e ASHSH-së; dr. Arian Leka, drejtori i Qendrës së Botimeve Enciklopedike; akad. Shaban Sinani, drejtues i redaksisë vendore dhe përgjegjës i seksionit për “Enciklopedinë shqiptare”; akad. Dhimitër Haxhimihali, akad. Marenglen Verli; akad. Sabri Hamiti, akad. Jusuf Bajraktari; akad. Fejzullah Krasniqi; prof. dr. Aljula Jubani; prof. dr. Valbona Toska, Lindita Pula, si dhe koordinatore Dafina Kavaja (ASHAK), Drisela Diamanati e Enkelejda Misha (ASHSH).

Takimi u mbajt për miratimin nga redaksia qendrore të fjalësve të 13 fushave:

arkeologjia; mesjeta, bizanti, periudha osmane + rilindja; komunikimi dhe mjetet e komunikimit; sistemet politike dhe drejtësia; diaspora; gjuhësia / albanologjia; artet; arsimimi; energjitë dhe energjitika; inxhinieritë, ndërtimtaria dhe arkitektura; mjekësia; letërsia; historia e shekulli XX, në vijim të takimit të mëparshëm që u mbajt në Durrës në datat 25-28 qershor 2025.



Në ditën e tretë u bënë diskutimet dhe konkluzionet përmbyllëse.

Në projektin madhor “Enciklopedia shqiptare” përfshihen 27 fusha. Me këtë takim përfundon procesi i njësimit të kriterit shkencor me tre bashkëpunuesit, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut.

www.akad.gov.al

Nisi punimet Kongresi European i Bioteknologjisë 2025

Më 11 shtator 2025 u mbajt për herë të parë në Tiranë Kongresi European i Bioteknologjisë.

Organizatore e këtij kongresi është Shoqata Europiane e Rrjetit Tematik të Bioteknologjisë (EBTNA) me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe institucioneve të saj: Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike, Njësia Kërkimore e Pasurive Ujore, Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës; si dhe me mbështetjen e Universitetit të Tiranës, Departamenti i Bioteknologjisë. Kontribuues në veprimtari janë edhe COST Action RECROP e MAGI Balkans.

Prof. dr. Ariola Bacu, drejtuese e Komisionit Organizativ Lokal të EBTNA-2025, hapi konferencën dhe shprehu falënderimet për pjesëmarrësit dhe institucionet mbështetëse.



Ajo ftoi kryetarin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushin, dhe zëvendës-presidentin e EBTNA-s, prof. dr. Oscar Vicente Mana, për të përshëndetur kongresin.

Fillimisht akad. Skënder Gjinushi dhe prof. dr. Oscar Vicente Mana firmosën marrëveshjen për anëtarësimin institucional dhe bashkëpunimin ndërmjet Shoqatës Europiane të Rrjetit Tematik të Bioteknologjisë (EBTNA) dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH).



Pas nënshkrimit të marrëveshjes, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Gjinushi përshëndeti pjesëmarrësit dhe organizatorët e kongresit.

Ai shprehu vlerësimin për lidhjen e marrëveshjes mes ASHSH-së dhe EBTNA-s dhe foli për strategjinë e bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar shkencor në fushat e bioteknologjisë, shkencave të jetës e arsimit.

Akad. Gjinushi e vuri theksi te bashkëpunimet në fushën e bioteknologjisë, të cilat janë zgjeruar me ngritjen dhe ndërkombëtarizimin e veprimtarisë së qendrave dhe njësive të ASHSH-së, drejtimit e të cilave përpunohen me ato të bioteknologjisë.

Kryetari i ASHSH-së tha se gjatë tetë vjetëve të reformimit të Akademisë së Shkencave, përvoja e organizimit të një sërë konferencave, shkollave me studentët, me doktorantët e rinj, si dhe ndërmarrja e disa projekteve të përbashkëta ka çuar në mënyrë të natyrshme në firmosjen e kësaj marrëveshjeje. Akademia e Shkencave ka shprehur vullnetin dhe dëshirën për ta çuar më para këtë bashkëpunim.

Prof. dr. Oscar Vicente Mana foli për rrugëtimin 15-vjeçar të Kongresit Europian të Bioteknologjisë të organizuar nga EBTNA (1996). Kongresi është i shtrirë në të gjitha disiplinat e bioteknologjisë. Në fund, prof. dr. Oscar Vicente falënderoi Kryesinë e Akademisë së Shkencave, organizatoren Ariola Bacu dhe institucionet pjesëmarrëse e mbështetëse në këtë kongres.

Kongresin e përshëndetën: rektori i Universitetit të Mjekësisë, prof. dr. Xheladin Draçini dhe dekania e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, prof. dr. Eglantina Kalluçi. Ata shprehën mirënjohjen për drejtuesit, mbështetësit dhe organizatorët e kongresit dhe e vunë theksin në kontributin e kësaj veprimtarie për brezin e ri të kërkuesve shkencorë, në gradimin e studentëve, doktoraturat, shkollat e trajnimit, si dhe rritjen e shkallës së profesionalizmit në kërkimin shkencor në bioteknologji, me ndikim në fushat jetësore,

si: mjekësia, produktet farmaceutike, gjenetika dhe nanoteknologjia.



Fjalë përshëndetëse mbajtën edhe prof. dr. Matteo Bertelli (MAGI Balkans) e prof. dr. Robert Marks (Universiteti "Ben Gurion" i Negev, Izrael), të cilët falënderuan institucionet shqiptare dhe veçanërisht Akademinë e Shkencave e studiuesit e saj për bashkëpunimin dhe organizimin e kongresit në Shqipëri.



Në ditën e parë u prezantuan 30 punime shkencore.

Seancën plenare e hapi akad. Anila Hoda, Sekretare shkencore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me prezantimin e punimit shkencor me temën: "Bioteknologjia për zhvillim të qëndrueshëm në blegtorinë dhe akuakulturën e Shqipërisë dhe të Kosovës".



Më tej, prezantuan prof. Ariola Bacu (ASHSH) organizatore e kongresit dhe kryetare e Grupit për Bioteknologji Molekulare, Universiteti i Tiranës; prof. Bashkim Ziberi, Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut; prof. Hysen Bytyqi, zëvendësrektor, Universiteti i Prishtinës, Kosovë etj.

Në këtë veprimtari marrin pjesë 200 kërkues shkencorë, lektorë, përfaqësues të industrive (ushqimore, farmaceutike, mjekësore), studentë të profileve të ndryshme nga vende të Bashkimit Europian, vende të Ballkanit Perëndimor, Kanadaja, Izraeli, Australia, Kina etj.

Kongresi Ndërkombëtar i Bioteknologjisë 2025 do të vijojë deri më 13 shtator 2025 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në sallat "Aleks Buda dhe "Libri Akademik".

Për më shumë, shiko linkun: <https://www.facebook.com/share/v/17L4dVbxuD/>
www.akad.gov.al

Mbylli punimet Kongresi European i Bioteknologjisë

Kongresi European i Bioteknologjisë 2025 u mbajt për herë të parë në Tiranë në datat 11-13 shtator 2025 dhe bëri bashkë 200 kërkues nga vende të ndryshme të botës, si SHBA-ja, Kanadaja, Australia, Kina, Europa, Lindja e Mesme etj. Veprimtaria u organizua nga Shoqata Europiane e Rrjetit Tematik të Bioteknologjisë (EBTNA) dhe u mbështet nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Universiteti i Tiranës.

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi dhe prof. dr. Oscar Vicente Mana, zëvendëspresident i EBTNA-s, nënshkruan marrëveshjen për anëtarësimin institucional dhe bashkëpunimin ndërmjet Shoqatës Europiane të Rrjetit Tematik të Bioteknologjisë (EBTNA) dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Ky aktivitet u drejtua nga prof. Ariola Bacu, kryetare e komitetit organizativ lokal të kongresit dhe profesoreshë në Universitetin e Tiranës.



Ekipe të kërkimore shqiptare prezantuan studime të avancuara në gjenomikë, nanoteknologji dhe bioteknologji mjedisore.

Prof. Anila Hoda, Sekretare e Përgjithshme e Akademisë së Shkencave; prof. Anila Babameto-Laku, drejtuese e laboratorit të gjenetikës në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza; prof. Bashkim Ziberi (Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut); prof. Hysen Bytyqi (Universiteti i Prishtinës, Kosovë), ndanë njohuri për

bashkëpunimin shkencor rajonal, duke nënvizuar shfaqjen e një rrjeti kërkimor ballkanik në rritje me një perspektivë të qartë europiane.

Gjatë kongresit u mbajtën 14 sesione me tematika nga bioteknologjia shtazore, gjenetika mjekësore, biokataliza/biotransformimi, bioteknologjia mjekësore, bioinformatika/biologjia e sistemeve, inxhinierimi i produkteve metabolike, inxhinieria e bioproceseve, nanobioteknologjia, biosensoret, shkencat omics, etika bioteknologjia mjedisore, biokarburantet, inxhinierimi i indeve etj., zhvillimi i të cilave në Shqipëri ka përparësi në kushtet e përafrimit të kërkimit shkencor dhe aplikimeve industriale të tij me ato europiane.



Gjithashtu, u organizuan: satellite, workshop on Cytotoxicity testing, workshop on Medical Genetics, workshop of Cost Action RECROP dhe shkolla e trajnimit në Bio-entrepreneurship.

Trajnimi i studiuesve të rinj ishte në qendër të punimeve të këtij kongresi me kurse praktike dhe punëtori, veçanërisht me kursin e tretë të bioteknologjisë, të organizuar nga MAGI Balkan për studentët e Universitetit të Tiranës.

Nëpërmjet projekteve dhe punimeve shkencore që u prezantuan në kongres, u theksua rëndësia e lidhjes së inovacionit ndërkombëtar me zhvillimin e qendrave kërkimore dhe forcimin e komunitetit shkencor të rajoneve euromesdhetare dhe ballkanike për të ndarë dhe diskutuar praktika, inovacione, nisma kërkimore dhe problematika të lidhura me bioteknologjitë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tyre. Me përcaktimin e saj si Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut për vitin 2025, Tirana

ofroi mjedisin ideal për një takim të tillë.



Kongresi Evropian i Bioteknologjisë 2025 konfirmoi se Ballkani dhe rajoni më i gjerë euromesdhetar janë pjesë integrale e së ardhmes së shkencës bioteknologjike. Në këtë ngjarje shkencore doli në pah edhe rëndësia strategjike e universiteteve dhe qendrave kërkimore në zonat euromesdhetare dhe ballkanike.

Veprimtaria u mbyll me shpalljen e fituesve: prezantimi më i mirë oral dhe prezantimi më i mirë poster.

Fitues për prezantimet më të mira orale u shpallën: Laurine Lagache, Tristan Cardon, Elsa Morina, Sara Feizyab.

Fitues për posterat më të mirë u shpallën: Piemonti Debora, Chiara Coppola, Suzanna Fekner, Christian Gratz.

Kongresi u pasqyrua gjatë gjithë këtyre ditëve në mediet ndërkombëtare, të cilat vijojnë të analizojnë arritjet dhe rëndësinë e veprimtarisë:

Shih linkun: <https://www.facebook.com/share/p/1FAPsqoNLV/>
www.akad.gov.al

Presidenti i Shoqatës Europiane të Rrjetit Tematik të Bioteknologjisë (EBTNA) i ka dërguar letër mirënjohjeje kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi për mbështetjen dhe kontributin e çmuar në organizimin e Kongresit European të Bioteknologjisë 2025 në Tiranë

Në letrën falënderuese, prof. Munis Dunder, president i EBTNA-s (European Biotechnology Thematic Network Association) shpreh mirënjohjen e thellë për akad. Skënder Gjinushin dhe Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, për mbështetjen e paçmuar dhe mikpritjen e ngrohtë gjatë kongresit, që mundësuan një platformë të shkëlqyer për bashkëpunim ndërkombëtar dhe promovimin e bioteknologjisë.

**EUROPEAN BIOTECHNOLOGY
THEMATIC NETWORK
ASSOCIATION**

18 August, 2025

Executive Committee of EBTNA
Munis Dunder
Oscar Vicente
Donald Martin
Tommaso Beccari
Anargyros Moulas
Martin Kjeller
Ratnesh Lal
Robert Marky
Iza Radeka
Luis Izquierdo Lopez
Dana Tapalawa
Qun Sun
Gary Henahan
Satya Prakash
Aniola Bacu
Michel Salfet
Matteo Bartelli


Dear Prof. Gjinushi,

On behalf of the European Biotechnology Thematic Network Association (EBTNA), I would like to express our deepest gratitude for your invaluable support and contribution to the organization of the European Biotechnology Congress 2025, hosted in Tirana.

Your leadership at the Academy of Sciences of Albania and your strong commitment to advancing science and innovation were essential in ensuring the success of this prestigious event. Thanks to your support and guidance, the congress provided a remarkable platform for international collaboration, knowledge exchange, and the promotion of biotechnology at the highest level.

We are truly honored by the warm hospitality and institutional support offered by the Academy of Sciences of Albania, and we look forward to strengthening our collaboration in the future.

With sincere appreciation,

**Prof. Munis Dunder**
The President of EBTNA

The European Biotechnology Thematic Network Association
The President

*European Biotechnology Thematic
Network
Association*
Executive Office
Piazza University
1 Perugia 06100
Italy

Official Website: www.ebtna.eu
Contact: info@ebtna.eu

Çel punimet Kongresi i 5-të Ndërkombëtar NanoBalkan (NB2025)

Kjo veprimtari shkencore organizohet nga nanoBalkan-Akademia e Shkencave e Shqipërisë, projekti SUSNANO i Universitetit të Tiranës, në bashkëpunim me Institutin Katalan të Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë, në Spanjë (ICN2), Fondacionin Fantom (Phantoms Foundation) në Spanjë dhe nën kujdesin e Qeverisë së Shqipërisë, duke mundësuar kështu, për të pestën herë radhazi, zhvillimin e këtij organizimi prestigjioz në Tiranë.



Në ceremoninë e hapjes së kongresit nderuan me praninë e tyre: Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama; Ministria e Arsimit, znj. Mirela Kumbaro; Ministria e Shtetit për Inteligjencën Artificiale, Diella; Ambasadori i Spanjës, z. Gabriel Cremades Ventura; Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi; zëvendësudrejtori i Institutit Katalan të Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë, z. José Garrido; anëtarë të Kryesisë së ASHSH-së, rektorë universitetesh, akademikë, profesorë, studiues etj.

Ceremoninë e hapi akad. Arben Merkoçi, drejtuesi i Njesisë nanoAlb. Ai tha se “Është një nder i madh për mua t’ju mirëpres të gjithëve në konferencën nanoBalkan 2025 në Tiranë, Shqipëri. Ne mbledhemi sot jo vetëm për të ndarë dije shkencore dhe arritje teknologjike, por edhe për të forcuar bashkëpunimin mes qeverisë, Akademisë dhe industrisë për të ardhmen e nanoteknologjisë. Kjo konferencë ofron një platformë unike, ku liderë, inovatorë dhe talente të reja bashkohen me një vizion të përbashkët: avancimin e shkencës, nxitjen e inovacionit dhe adresimin e sfidave më urgjente të

kohës. Prania e të ftuarve të nderuar nga 22 vende tregon rëndësinë e misionit tonë të përbashkët. Pjesëmarrja juaj tregon, gjithashtu, mbështetjen e fortë për nismën që po ndërtojmë në Tiranë: krijimin e një Qendre Rajonale për Nanoteknologji, modeluar sipas Institutit Katalan të Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë, ICN2 në Barcelonë, Spanjë. Vizionin tonë e përbën themelimi jo vetëm i një qendre ekselence kërkimore, por edhe i një pike takimi për bashkëpunim ndërkombëtar, duke lidhur Ballkanin me komunitetin shkencor global.”



Akad. Merkoçi falënderoi ambasadorin z. Gabriel Cremades Ventura për mbështetjen e vazhdueshme ndaj qendrës nanoBalkan dhe aktiviteteve të kësaj natyre.

Ambasadori i Spanjës, z. Gabriel Cremades Ventura, tha se gjatë dekadave të fundit nanoteknologjia është zhvilluar në një forcë vërtet transformuese. Ne e kemi parë ndikimin e saj në sektorë të ndryshëm: nga mjekësia dhe energjia, te shkenca e materialeve, elektronika dhe qëndrueshmëria mjedisore. Ai theksoi se Instituti Katalan i Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë, që përfshin vizionin e profesorit Arben Merkoçi dhe që është shembull i ekselencës spanjolle në kërkimin shkencor e teknologjik, po shërben si model i përsëritur për krijimin e nanoBalkan-it, Qendra Rajonale për Nanoteknologji.

Më tej, ambasadori nënvizoi se qeveria spanjolle është shumë e përkushtuar në shfrytëzimin e teknologjisë për rritje ekonomike, efikasitet të sektorit publik dhe konkurrueshmëri globale. Duke u ndalur te vendi ynë, ai tha se Shqipëria ka treguar, gjithashtu, një përkushtim të jashtëzakonshëm për të përqafuar të ardhmen digjitale jo thjesht si objektiv politik, por si prioritet kombëtar transformues.



Punimet e kongresit i përshëndeti dhe Diella, ministre e Shtetit për Inteligjencën Artificiale. Ajo tha se nanoteknologjia është dëshmi se në përmasa më të vogla mund të fshihen revolucionet më të mëdha. Kërkimet shkencore do të rregullojnë të ardhme të reja në shumë fusha të jetës. Inteligjenca Artificiale dhe nanoteknologjia nuk janë rrugë paralele, ato janë forca që po bashkohen.



Në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Kryesisë së saj, kongresin e përshëndeti akad. Anila Hoda, sekretarja shkencore. Ajo tha se veprimtari të tilla shkencore shërbejnë si ura që lidhin dijen me zhvillimin, risitë shkencore me zbatimin e tyre në ekonomi e industri, si dhe rajonin tonë me trendet më të fundit botërore. Ngjarje të tilla, përveç nxitjes së debatit shkencor midis specialistëve, kanë për qëllim të sensibilizojnë institucionet politikëbërëse për mbështetjen e kërkimit shkencor. Këtu është rasti të falënderojmë praninë e përfaqësuesve të qeverisë dhe të vetë

Kryeministrit, duke e vlerësuar si një mbështetje të çmuar për komunitetin shkencor shqiptar në tërësi dhe për njësinë e nanoshkencës me 27 njësitë pranë saj, të shtrira në të gjithë rajonin. Nanoteknologjia është pa dyshim teknologjia e këtij shekulli dhe ne ndihemi të privilegjuar që shkencëtarë e kërkues nga më të shquarit e më të suksesshmit janë miqtë tanë sot këtu në Tiranë.



Ministrja e Arsimit, znj. Mirela Kumbaro, i shprehu mirënjohjen e thellë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që mirëpriti në kopshtin e vet të dijes filizat e nismës nanoAlb dhe nanoBallkan për të krijuar një qendër nanoteknologjie në Shqipëri. Ajo theksoi se tani është koha që ta ngremë në një nivel tjetër, duke përfshirë kontributin e universiteteve shqiptare, universiteteve të rajonit në bashkëpunim me fakultetet apo departamentet e shkencave ekzakte dhe të inteligjencës artificiale. Ajo theksoi se është e rëndësishme që të përfshihen studiuesit e rinj në nivelet e ciklit të dytë, të tretë, por edhe atë të nivelit postdoktoral të kërkimit shkencor.



Shkenca nuk njeh kufi, ashtu si lumi i Vjosës, që u përfshi në listën botërore të UNESCO-s, edhe nanoBallkan është një dëshmi e gjallë që mund të vijojë, -tha ajo, duke i dhënë fjalën Kryeministrit të Shqipërisë, z. Edi Rama.



Kryeministri Rama e cilësoi shfrytëzimin e Inteligjencës Artificiale si një shtyllë themelore të qeverisjes, jo thjesht një instrument. Është përparësi jona kyçe dhe vizioni ynë kombëtar për Shqipërinë e 2030-s në BE, besoj se shumë i qartë, shumë qartësisht i rrënjosur në integritet, novacion dhe udhëheqje shkencore. Ne do të kanalizojmë më shumë burime, reforma institucionale, kapital njerëzor për të ndihmuar në ndërtimin e një ekosistemi të nanoteknologjisë që e ka spirancën në Tiranë, por që rrezaton apo më mirë zgjeruar jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë.

Duke kujtuar themelimin e nanoAlb-it, pesë vjet më parë, Kryeministri Rama theksoi se ai ishte gjithashtu dhe një sinjal i një akademie të ripërtëritur shkencash, i një akademie shkencash që u shfaq e gatshme për të përqafuar të ardhmen, e jo për të mbetur serish në të shkuarën.

Kryeministri garantoj se vizioni i qeverisë është që brenda dekadës tjetër çdo i ri shqiptar që aspirojnë të studiojnë teknologjitë e së ardhmes të mund ta bëjë këtu në shtëpi. Është një punë që ka nisur e po shohim tashmë hapat e parë dhe po kështu edhe rezultatet e para që janë inkurajuese. Ky investim në arsim ka të bëjë edhe me krijimin e një hapësire për njerëzit që të mendojnë në mënyra novatore, të krijojnë një brez novatorësh që do të çojnë përpara ekonominë shqiptare, industrinë, e qeverisjen shqiptare.

Pres me shumë padurim që të punojmë ngushtë me Akademinë e Shkencave për t'i bërë gjërat më mirë e për ta bërë përparimin më të prekshëm.



Veprimtaria do të zgjasë 5 ditë, në seanca plenare dhe seksione paralele bazuar në tema shumë aktuale dhe inovative, si Atoms and Molecular Computing, Graphene & 2DM / Carbon nanotubes, Low dimensional materials (nanowires, clusters, quantum dots, etc.), Nanobiotechnologies & Nanomedicine, NanoChemistry and Nanofabrication tools & nanoscale integration, Nanomaterials for Energy, Nanosensors etj.

Për më shumë, shih linkun:

<https://www.facebook.com/share/v/1Cmdzj4UvK/>

<https://www.nanobalkanconf.com/2025/program.php>

Kryeministri z. Edi Rama përshëndet Kongresin e 5-të Ndërkombëtar NanoBalkan (NB2025)

-Kryeministri Rama: NanoAlb, një sinjal i një Akademie Shkencash të ripërtëritur, gati për të përqaftuar të ardhmen-

-Kryeministri Rama: Do të punojmë ngushtë me Akademinë e Shkencave për t'i bërë gjërat më mirë dhe për ta bërë përparimin më të prekshëm-



Fjala e plotë

Besoj se sot gjendemi në një ag të ri për Shqipërinë si një komb që guxon të udhëheqë e jo të ndjekë, në ballë të shkencës e teknologjisë në këtë rajon.

Më lejon të them që, duke krijuar një ministre të Inteligjencës Artificiale, ministrja e parë në botë e Inteligjencës Artificiale, Shqipëria nuk po përqafton thjesht të ardhmen, por po përpiqet të bëjë pjesën e saj për ta projektuar atë. Diella nuk është një lodër, përmes saj ne kemi shndërruar atë çfarë ka qenë domeini i së mjegulltës në një algoritëm transparent për të shndërruar pushtetin e shtetit në pushtetin e shërbyesit. Në fakt, jemi të bindur që herët më shumë sesa vonë do të jemi në gjendje të ofrojmë përmes Diellës një instrument të jashtëzakonshëm për t'i bërë tenderat publikë, të hapur, transparentë e në integritet siç nuk është parë më parë.

Siç e thashë, Shqipëria është një vend që guxon dhe shfrytëzimi Inteligjencës Artificiale është një shtyllë themelore e qeverisjes, jo thjesht një instrument. Është përparësi jona kyçe dhe vizioni ynë kombëtar për Shqipërinë e 2030-s në BE besoj është shumë i qartë, shumë qartësisht i rrënjësuar në integritet, novacion dhe udhëheqje

shkencore. Kjo ngjarje ilustron shumë më tepër se fjalët, ajo shpreh atë çfarë po synojmë të bëjmë, e bëjmë çdo ditë. Ne do të kanalizojmë më shumë burime, reforma institucionale, kapital njerëzor për të ndihmuar në ndërtimin e një ekosistemi të nanoteknologjisë që e ka spirancën në Tiranë, por që rrezaton apo më mirë zgjeruar jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë. Do të dëshironim që çdo program i madh i novacionit, çdo terren shkencor, çdo projekt infrastrukture do të ketë standarde të larta, llogaridhënie të plotë, dhe gjithashtu edhe mbikëqyrje të ndihmuar nga Inteligjenca Artificiale.



Kur u themelua nanoAlb-i pesë vjet më parë, ishte gjithashtu dhe një sinjal i një akademie të ripërtëritur shkencash, i një akademie shkencash që u shfaq e gatshme për të përqafuar të ardhmen, e jo për të mbetur sërish në të shkuarën. E nuk ka aspak dyshim se nanoshkenca dhe nanoteknologjia janë shkencë kampione të shekullit XXI dhe ne duhet dhe mundemi që të harmonizojmë arsimin e lartë në strategjinë tonë për novacionin, në klasat, laboratorët e startup-eve dhe në fakt në universitete shqiptare po hartohen programe ndërdisiplinore për sistemet digjitale, dhe së shpejti për inteligjencën artificiale dhe për nanoshkencat, sepse ky nuk është një luks apo diçka shumë e veçantë. Kjo është një nevojë e së tashmes.

Vizioni ynë është që brenda dekadës tjetër çdo i ri shqiptar që aspirojnë të studiojë teknologjitë e së ardhmes të mund ta bëjë këtu në shtëpi. Ne do të kërkojmë partneritete me universitete europiane dhe institute kërkimore, duke u siguruar që kurikula jonë të përputhet me standarde më të larta ndërkombëtare. Kjo është një punë që ka nisur e po shohim tashmë hapat e parë dhe po kështu po shohim edhe rezultatet e para që janë

inkurajuese. Ky investim në arsim nuk ka të bëjë vetëm me prodhimin e shqiptarëve dhe të inxhinierëve, por edhe me krijimin e një hapësire për njerëzit që të mendojnë në mënyra novatore, të krijojnë një brez novatorësh që do të çojnë përpara ekonominë shqiptare, industrinë e qeverisjen shqiptare.



Shqipëria është shumë e angazhuar që çdo euro e investuar në shkencë të përkthehet në përparim të prekshëm në llogaridhënie dhe në mundësi për të rinjtë tanë. Dhe nuk ka aspak dyshim, ashtu siç disa prej jush që kanë ardhur nga jashtë mund të shohin tashmë, se ky është një vend shumë i hapur, shumë miqësor dhe është një vend ku fjala “mirë se erdhët” është në përputhje të përkryer me atë çfarë mund të presësh kur vjen në këtë vend. Ndaj mirë se erdhët!

Pres me shumë padurim që të punojmë ngushtë me Akademinë e Shkencave për t’i bërë gjërat më mirë e për ta bërë përparimin më të prekshëm. Faleminderit shumë!

www.akad.gov.al

Skënder Gjinushi në konferencën shkencore ndërkombëtare “Qytetet pas tranzicionit në vendet postkomuniste”



Të nderuar pjesëmarrës, kolegë, miq e të ftuar,

Është një kënaqësi e veçantë për mua t'ju përcjell përshëndetjet e Akademisë së Shkencave, duke i uruar punime të mbara konferencës së 11-të me temën: “Qytetet pas tranzicionit në vendet postkomuniste”.

Ne i falënderojmë organizatorët që zgjodhën Tiranën për zhvillimin e këtij eventi të rëndësishëm shkencor, si dhe për ta përfshirë Akademinë si bashkorganizatore.

Pjesëmarrja e gjerë në këtë konferencë të rreth 200 specialistëve nga e gjithë bota janë një tregues për interesin në rritje ndaj kësaj iniciative, si dhe me sa duket, edhe për kërshërinë në rritje që po tregon zhvillimi kontrovers i qytetit të Tiranës.

Termi tranzicion është bërë mjaft stresues për popujt e vendeve tona, kuptimi e kalimi i kësaj periudhe përbënin një sfidë të panjohur për nga rrugëtimi e kohëzgjatja për të gjitha vendet në tërësi e për qytetet në veçanti. Pavarësisht nga pritshmëritë e parashikimet, një gjë ishte e qartë se qytetet do të luanin rolin promotor në këtë periudhë, ndërsa kryeqytet atë të lokomotivës, si dhe do të përjetonin më drejtpërdrejt problematikat e tij. Sigurisht, çdo vend e qytet ka pasur pikënisje të ndryshme e zgjedhi rrugë e zgjidhje të ndryshme.

Me gjithë diferencat ka qenë e mbetet i domosdoshëm shkëmbimi i përvojës midis vetë qyteteve, politikëbërësve, si dhe midis profesionistëve, gjeografëve, urbanistëve, sociologëve etj., për të përfituar nga praktikat më të mira, sidomos në

përballimin e problemeve të përbashkëta a të ngjashme.



Qytetet tona u ndeshën me problemet e lëvizjeve të mëdha demografike me pasojë mbipopullimin e disave, veçanërisht qyteteve të mëdha, a zbrazjen e disa të tjerëve, me zëvendësimin e një zhvillimi urban të supercentralizuar me ndërtimet e pakontrolluara, ato ndeshen veçanërisht me problemet e zhvillimit perspektiv në zgjedhjen e zhvillimit horizontal a vertikal, me problemet e ndotjes e mbetjeve urbane, e ndikimit në ngrohjen globale në ruajtjen e trashëgimisë kulturore në qytetet patrimuan të UNESCO-s, raportet midis së resë e së vjetrës, zgjidhjes në afatgjatë të problemeve të infrastrukturës bazë e jetësore e përballimin e tërmeteve, e së fundi në raport me kthimin në smart city.

Qyteti i Tiranës është një shembull i mirë si për të kuptuar se çfarë s’duhet bërë, siç ishte modeli i ndërtimeve pa leje, ashtu dhe për të parë se çfarë duhet bërë, duke u nisur me ritmet e prirjet e reja e kalimit nga kioskat pa leje në kullat me leje.

Por këto do t’i thonë më mirë specialistët e profesionistët; për të gjitha këto ju do të keni rastin të debatonit midis jush, prandaj duke falënderuar edhe një herë organizatorët, përfshirë dhe Njësinë tonë të re të gjeografisë, i uroj punime të mbara konferencës së 11-të e të gjithë pjesëmarrësve një qëndrim të këndshëm në qytetin e Tiranës.

www.akad.gov.al

Mbledhje të komisioneve të përhershme të ASHSH

U zhvillua mbledhja e Komisionit të Përhershëm të Arteve

Në datën 30 shtator 2025, Komisioni i Përhershëm i Arteve, nën drejtimin e kryetarit akad. Vasil S. Tole, zhvilloi një mbledhje me pjesëmarrjen e anëtarëve: z. Altin Basha, znj. Suzana Varvarica-Kuka, akad. Stefan Çapaliku, znj. Belfjore Qose, z. Namik Dokle, z. Arben Llozi, z. Denis Bizhga dhe znj. Abigeila Voshtina.



Gjatë takimit, anëtarët u njohën me programin e konferencës mbarëkombëtare të muzikës "Muzika shqiptare si krijimtari, interpretim dhe edukim artistik".

Veprimtaria është një iniciativë e Komisionit të Përhershëm të Arteve, e cila do të zhvillohet në kuadër të Muajit të Letërsisë dhe Arteve dhe organizohet në bashkëpunim me Qendrën e Studimit të Arteve, Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit, Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Prishtinës, Liceun Artistik "Jordan Misja", Orkestrën Simfonike të RTSH-së, AKKSHI-n, ASCAL-in dhe Qendrën e Kulturës dhe Botimeve të Mbrojtjes.

Një tjetër pikë e rëndësishme e mbledhjes ishte pasurimi i Komisionit me anëtarë të rinj. Gjithashtu, u diskutua për përfshirjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm, veçanërisht shqiptarë të suksesshëm jashtë vendit, në fusha, si: muzika, letërsia, kinematografia dhe artet pamore.

Komisioni shprehu miratimin për emrat e propozuar dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe promovimit të talenteve shqiptare.

www.akad.gov.al

U mbajt referati me temën “Vota e diasporës, eksperiencia ndërkombëtare dhe modeli shqiptar” nga dr. Ilirjana Nano

Në datën 30 shtator, në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave, u mbledh Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Shkencave Sociale dhe Juridike nën drejtimin e kryetarit të tij, akademik Anastas Angjeli.



Mbledhja u mbajt me prani fizike dhe online të anëtarëve të Komisionit.

Fillimisht, anëtarja e Komisionit dr. Ilirjana Nano mbajti referatin me temën “Vota e diasporës, eksperiencia ndërkombëtare dhe modeli shqiptar”.

Në këtë punim shkencor u trajtua votimi për herë të parë i shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025.



Referati u përqendrua në aspektet e një analize të zhvillimeve ligjore mbi votën e diasporës në pesë vitet e fundit, raportin e votimit brenda vendit me atë jashtë vendit nën këndvështrimin e standardeve kushtetuese, duke trajtuar të drejtën e votës dhe procedurat ligjore si garanci për zbatimin e kësaj të drejte.

Gjithashtu, gjatë referimit u paraqitën para anëtarëve të Komisionit eksperiencat dhe modelet ndërkombëtare për votimin nga jashtë vendit, duke i krahasuar ato me modelin e zgjedhur nga Shqipëria, si dhe analiza pse u zgjodh ky model.

Në përfundim të referatit, anëtarët e Komisionit të pranishëm në mbledhje bënë pyetje dhe u diskutuan aspekte të financimit të procesit të votimit nga jashtë vendit, si dhe u paraqitën disa çështje për diskutim publik e ligjor për përmirësimin e këtij procesi në të ardhmen.



Më pas, sipas pikës së dytë dhe të tretë të rendit të ditës, vijuan diskutimet për përgatitjet për konferencën e përbashkët me Kosovën (10-11 tetor 2025) dhe modelet më të mira të përfaqësimit demokratik të votuesve jashtë vendit.

www.akad.gov.al

Aktivitete

U mbajt takimi dyditor me temën: “Kontributi i diasporës shkencore për integrimin në hapësirën europiane të kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë në trojet shqiptare”

Veprimtaria u mbajt në sallën “Aleks Buda”, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Organizatorë të këtij takimi janë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin Alb-Shkenca (IASH) dhe Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.

Seancën e parë, me temën “Takimi i 20-të jubilar dhe kontributi në vite i IASH-së në hapësirën shqipfolëse”, e moderoi prof. Ardian Maçi, kryetar i degës së Shqipërisë të IASH-së.



Gentian Zyberi, kryetar i përgjithshëm i Institutit Alb-Shkenca, mbajti fjalën e hapjes së veprimtarisë. Ai u shpreh se kjo organizatë ka rol jetik në kërkimin shkencor dhe arsimin e lartë në komunitetin shqiptar dhe më gjerë. Gjatë 20 vjetëve, IASH-ja ka ngritur ura lidhëse mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, duke e mbajtur gjallë hapësirën e diasporës shqiptare, duke pasur parasysh lirinë akademike.

Më tej, ai e vuri theksin në kontributin e IASH-së në përmirësimin, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet studiuesve shqiptarë dhe atyre ndërkombëtarë në fusha të ndryshme shkencore, me misionin që të promovojë, të zhvillojë dhe të avancojë kërkimin shkencor, duke u lidhur me strukturat akademike të Europës si një burim i pashtershëm dijeje dhe inovacioni. Prof. Zyberi foli edhe për

integrimin e sistemeve tona arsimore për të ndërtuar një të ardhme, ku kërkuesi shkencor shqiptar mund të bashkëpunojë drejtpërdrejt me kolegët në rajon, Europë e më gjerë, për të krijuar zgjidhje inovative, të cilat do të formësojnë botën e nesërme.

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, mbajti fjalën përshëndetëse. Ai u uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe shprehu kënaqësinë për organizimin e këtij aktiviteti në mjediset e ASHSH-së.



Akad. Gjinushi e vuri theksin në misionin e përbashkët të të dyja institucioneve për rritjen e nivelit dhe zgjidhjen e problemeve të kërkimit shkencor në të gjitha hapësirat shqiptare.

Ai tha se Akademia e Shkencave luan rolin e koordinuesit në të gjithë hapësirën mbarëshqiptare nëpërmjet njësive të kërkim-studimit, komisioneve, si dhe nëpërmjet anëtarëve të jashtëm në këto struktura me përfaqësuesit shqiptarë më të suksesshëm.

Akad. Gjinushi theksoi se është detyrë e institucioneve që të afrojnë diasporën në strukturat e kërkimit shkencor. ASHSH-ja ka mjaft përfaqësues të diasporës në aktivitetet që zhvillohen brenda saj, me të cilët punojmë. Akad. Gjinushi foli edhe për dukurinë e largimit të trurit jashtë vendit. Ai tha se kapacitetet intelektuale në fushën e shkencës janë më të mëdha jashtë sesa brenda vendit. Akademia e Shkencave ka luajtur e do të luajë një rol të rëndësishëm në shfrytëzimin e kapaciteteve shkencore që janë jashtë vendit nëpërmjet bashkëpunimit në distancë, përmes teknologjive të reja të komunikimit.

Në fund, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Gjinushi, shprehu gatishmërinë për përkrahjen dhe forcimin e lidhjeve me diasporën shkencore shqiptare, me qëllim që të përfshihen institucionet në programet e zhvillimit kombëtar dhe të integrohen në kërkimin shkencor europian.

Ndërsa e vuri theksin te strategjitë që Akademia e Shkencave po ndjek për rritjen

e kapaciteteve të kërkimit shkencor, ai tha se duhen strategji konkrete për të përmirësuar treguesit financiarë, për të financuar dhe mbështetur realisht kërkimin shkencor. Shqipëria është larg, në më pak se 1% të GDP-së, ndaj i duhet bërë më shumë presion qeverisë për të mbështetur kapacitetet e kërkimit shkencor në funksion të rritjes së rolit të shkencës në zhvillimin kombëtar dhe promovimin e përfaqësuesve të saj brenda dhe jashtë vendit, si dhe në realizimin e projekteve kërkimore-shkencore. Kërkimi shkencor nuk është luks, por domosdoshmëri për të njëjshuar nivelin e kërkuesve shkencorë për përshpejtimin e proceseve të eurointegrit, sepse Shqipërisë nuk i mungojnë kapacitetet, -tha akad. Gjinushi.

Prof. dr. Niko Qafoku, Kryetar Nderi i Institutit Alb-Shkenca, në fjalën përshëndetëse paraqiti fillimisht gjendjen e arsimit të lartë dhe shprehu dëshirën për të ndihmuar arsimin e lartë në Shqipëri, veçanërisht Akademinë e Shkencave në shkencat e aplikuara.



Zëvendësministrja e Ministrisë së Arsimit, znj. Ana Kapaj, përshëndeti pjesëmarrësit dhe foli për politikën dhe strategjitë që ka hartuar institucioni për përfshirjen e diasporës në kërkimin shkencor. Ajo tha se diaspora shërben si urë lidhëse e kërkimit shkencor dhe arritjet e kërkuesve shkencorë të saj duhet t'i kthejmë në aset kombëtar. Ministria e Arsimit, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, ka disa projekte bashkëpunimi me diasporën.

Prof. dr. Eglantina Kalluci, dekane e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, foli për strategjitë e mbështetjes institucionale. Ajo tha se bashkëpunimi i kahershëm me diasporën shkencore shqiptare i ka dhënë tjetër frymë e

tjetër qasje kërkimit shkencor dhe institucionet e tyre akademike kanë bashkëpunuar në projekte të përbashkëta me IAL-të shqiptare e më gjerë.

Më tej, përshëndetën prof. dr. Eshref Januzaj, nënkryetar i përgjithshëm i Institutit Alb-Shkenca të Tiranës, dhe prof. dr. Bajram Berisha (Universiteti i Prishtinës).



Në seancat plenare që u zhvilluan gjatë ditës së sotme studiuesit mbajtën kumtesa në fushat specifike të hulumtimit e të ekspertizës: filologji, histori dhe kulturë, drejtësi, ekonomi, bujqësi dhe agrobiznes, shkencat e natyrës dhe mjedisi, mjekësi, inxhinieri, teknologji e informacionit dhe komunikimit, shkenca shoqërore dhe politikë.

Dita e parë e Takimit XX të IASH-së u mbyll me pyetje, diskutime dhe konkluzione.

Dita e dytë u mbajt të shtunën, më 27 shtator 2025, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

www.akad.gov.al

U mbajt forumi akademik/workshop me temën “Tektonika aktive dhe burimet sizmike për modelimin sizmotektonik në Shqipëri”

Veprimtaria u organizua nga Njësia kërkimore e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Kërkimeve Shkencore të Italisë (CNR), Shërbimin Gjeologjik Shqiptar dhe Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”.

Qëllimi kryesor i këtij forumi është trajtimi i çështjeve thelbësore që lidhen me përcaktimin sa më të saktë të strukturave tektonike aktive në territorin shqiptar; vlerësimin e burimeve sizmike ekzistuese dhe potenciale; përditësimin e modelit kombëtar sizmotektonik dhe thellimin e njohurive mbi marrëdhëniet ndërmjet tërmeteve dhe strukturave aktive.

Në këtë veprimtari ishin të pranishëm kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi; sekretarja shkencore e ASHSH-së akad. Anila Hoda; kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike akad Neki Frashëri etj.



Akad. asoc. Rapo Ormeni, drejtues i Njesisë kërkimore të gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive, ASHSH, u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve. Ai vuri në dukje se Shqipëria ndodhet në një zonë me aktivitet sizmik të lartë, pjesë e brezit sizmik alpin mesdhetar. Tërmeti shkatërrues i 26 nëntorit 2019 (6.4 ballë), si dhe shumë tërmete të tjera të dokumentuara historikisht, nënvizojnë domosdoshmërinë për vlerësim të ri dhe të saktë të burimeve sizmike në territorin shqiptar dhe hartimin e një modeli të përditësuar sizmotektonik, të mbështetur në të dhëna dhe metoda moderne.

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, në fjalën përshëndetëse theksoi se puna e Njesisë së gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierisë, që ka si qëllim nxitjen dhe koordinimin në studime dhe projekte shkencore të nivelit elitari në fushën e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierisë, po ndiqet me shumë interes. Ai përmendi faktin që njësia ka zgjeruar kufijtë e bashkëpunimit. Studimet në këto fusha u nxitën pas tërmetit të 26 nëntorit 2019 në bashkëpunimin e vazhdueshëm midis qendrave kërkimore, institucioneve të kërkimit, shkencëtarëve dhe studiuesve që mbulojnë kërkimin në fushat e gjeologjisë, në fushat inxhinierike, kudo që janë, në rajon, Europë e më gjerë. Akad. Gjinushi vuri në dukje se studimet e territorit shqiptar hasin në problematika shumë të mprehta, duke e vënë theksin tek rëndësia e integritetit të dhënave gjeologjike dhe sizmologjike, për parandalimin apo qëndrueshmërinë e ndërtimit të veprave inxhinierike nga rreziku sizmik.



Prof. dr. Luigi Piccardi, anëtar i Këshilli Kombëtar të Kërkimeve Shkencore, Itali (CNR), falënderoi Akademinë e Shkencave për bashkëpunimin dhe shprehu kënaqësinë e pjesëmarrjes me një studim mbi rajonet shqiptare. Ai u shpreh se të dyja vendet fqinje, Shqipëria dhe Italia nuk kanë vetëm afërsi territoriale, por kanë edhe një histori shumë të gjatë bashkëpunimesh.

Forumin e përshëndeti edhe prof. dr. Naser Peci, zëvendës drejtues i Njesisë kërkimore të gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive (ASHSH), Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”. Ai e vlerësoi workshop-in si një hap të rëndësishëm drejt rritjes së ndërgjegjësimit dhe forcimit të kapaciteteve institucionale në menaxhimin e rrezikut sizmik, duke kontribuar në përmirësimin e politikave për ndërtim të qëndrueshëm dhe

siguri publike.



Prof. dr. Luigi Piccardi hapi seancën e parë të forumit me prezantimin e kërimit shkencor me temën “ Kufizime paraprake nga thyerjet aktive dhe sizmiciteti historik në Shqipëri: hapa drejt një sinteze sizmotektonike kombëtare.

Në ditën e dytë u mbajt tryeza e rrumbullakët me pyetje, diskutime dhe shkëmbime të hapura idesh e perspektivash midis pjesëmarrësve për modelin përfundimtar sizmotektonik të Shqipërisë.

Në këtë tryezë u diskutuan rezultatet dhe interpretimet kryesore të paraqitura gjatë seminarit dhe u la detyrë që të identifikohen boshllëqet shkencore, pasiguritë dhe prioritetet për kërkime të mëtejshme dhe të përpunohen një sërë rekomandimesh që do të udhëheqin zhvillimin e modelit përfundimtar sizmotektonik të Shqipërisë; të bëhet hartimi i përbashkët i propozimeve në lidhje me strukturën, parametrat dhe zbatimin e modelit përfundimtar sizmotektonik, si prezantimi i një modeli paraprak sizmotektonik për diskutim, me qëllim finalizimin e modelit përfundimtar sizmotektonik.

Gjatë dy ditëve (23-24 shtator 2025) të këtij forumi u prezantuan 20 punime, qasje të avancuara shkencore në analizën e rrezikut sizmik dhe për hartimin e një modeli të integruar, në funksion të qëndrueshmërisë urbane dhe mbrojtjes së jetës njerëzore.

Pas përfundimit të seancave shkencore, një grup studiuesish dhe specialistësh: Rrapo Ormeni, Luigi Piccardi, Ismail Hoxha, Eutizio Vittori, Naser Peci, Pio Di Manna, Petraq Naço, Bexhet Shala, Dionald Mucaj, Dashamir Gega, Olgert Gjuzi, Erald Silo, u nisën për një udhëtim dyditor në terren për vëzhgimin e tipareve të rëndësishme tektonike në zonën Mirditë–Peshkopi–Kukës–Prizren.

www.akad.gov.al

Mbyllen punimet e Kongresit të 13-të të Studimeve të Europës Juglindore në Shkup

Në datat 15-19 shtator në Akademinë e Shkencave të Maqedonisë në Shkup u zhvilluan punimet e Kongresit të 13-të të Studimeve të Europës Juglindore, me orientim nga disiplinat historiografike, studimet e krahasuara në shkenca humane, antikiteti e mesjeta e vonë, gjurmimet filologjike e tekstore, toposet dhe elementet e qytetërimit në kulturat e Ballkanit, shkencat politike, zhvillimet historiko-shoqërore në bashkëkohësi etj.

Në sesionet shkencore tematike të kongresit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë u përfaqësua nga studiues me kontribute të spikatura në disa fusha studimore.

Në ditën e parë të kongresit, akademik Pëllumb Xhufi (Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, ASHSH), drejtues i sesionit shkencor për marrëdhëniet ekonomike dhe ndikimin përkatës që në shekujt e hershëm deri në kohë më të vona, paraqiti punimin me titull “Voskopja and the Economic Motif of Its Flourishing and Decline”;



prof. as. dr. Aristotel Spiro (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASHSH), drejtues i sesionit shkencor për shkëmbimet kulturore nga antikiteti, mesjeta deri në kohët e

sotme, referoi punimin me titull “The philological sorrows of dead Constantine’s sister on her journey through three languages”.



Dr. Olimbi Velaj (Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës), në sesionin shkencor për rolin e emigrantëve në zhvillimet shoqërore, politike dhe kulturore, paraqiti punimin me titull “The role of intellectuals in the collection of folklore in the Balkans in the 19th century, the first collections of Slavs and Albanians”.



Në ditën e dytë të kongresit, në sesionin shkencor kushtuar çështjeve identitare në Europën Juglindore në një vështrim retrospektiv historik, prof. dr. Paskal Milo

(Akademia e Shkencave e Shqipërisë) paraqiti punimin me titull “Post-Conflict Agreements in the Western Balkans After the Fall of Communism: A Comparative Approach”;



prof. dr. Ksenofon Krisafi (Universiteti Mesdhetar i Tiranës) paraqiti punimin me titull “The Albanian League of Prizren: The Foundation of the Modern Albanian State”.



Në sesionin shkencor kushtuar çështjeve të interferencave gjuhësore e kulturore në Europën Juglindore, prof. as. dr. Evalda Paci (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASHSH), paraqiti punimin “Sur la reconnaissance des éléments représentatifs dans les œuvres de la littérature albanaise ancienne”;



Dr. Valbona Sinanaj (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASHSH), paraqiti punimin me titull “Bilingualism - opportunities for mutual linguistic, social and cultural interactions”.



Në ditën e tretë të kongresit, në sesionin shkencor për komunikimin dhe shkëmbimet përmes burimeve muzeale, arkivave, fotografisë, kinematografisë, shtypshkrimit në Europën Juglindore, prof. dr. Tomorr Plangarica (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASHSH), paraqiti punimin “Coopération entre les chercheurs et les institutions scientifiques dans les pays de l’Europe du Sud-Est - prémisse d’une institutionalization cognitive/intellectuelle et sociale plus rapide des connaissances et des disciplines scientifiques dans les pays respectifs”.



Punimet shkencore të paraqitura nga profesorët dhe studiuesit shqiptarë në Kongresin e 13-të të “Association Internationale d’Études du Sud-Est Européen” në Shkup, theksuan rëndësinë e qasjeve tematike, ndërdisiplinore të kontekstit shqiptar në një veprimtari ndërkombëtare prestigjioze të përqendruara në zhvillimet e vendeve të rajonit të Ballkanit dhe më gjerë.



Përgatitja për botim e 11 punimeve të plota studimore do të reflektojë angazhimin e studiuesve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në këtë veprimtari të rëndësishme shkencore ndërkombëtare.

www.akad.gov.al

U zhvillua konferenca shkencore me temën "Identitete religjioze në trojet shqiptare nga Mesjeta e Vonë deri ne rënien e Perandorisë Osmane"

Veprimtaria u mbajt në datën 29 shtator 2025 në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nga Instituti i Historisë, Departamenti i Mesjetës dhe i Rilindjes, ASHSH, në bashkëpunim me Institutin e Historisë "Ali Hadri", Prishtinë.

Qëllimi i konferencës shkencore ishte ofrimi i një panorame të plotë dhe shumëdimensionale mbi historinë e religjioneve, mbi institucionet fetare dhe mbi fenomenet e ndryshme të jetës shpirtërore në hapësirat shqiptare, nga mesjeta deri në fillim të shekullit XX.



Një nga boshtet kryesore të konferencës ishte identiteti kulturor dhe fetar, i lexuar përmes simboleve dhe shenjave që mbijetuan në kujtesën popullore.

Një bllok i rëndësishëm i punimeve shkencore lidhej me strukturat kishtare dhe institucionale.

Diskutimet u përqendruan te Ipeshkvia e Drishtit, duke u mbështetur në burime historike dhe në dëshmi arkeologjike, si edhe te organizimi i jetës kishtare sipas statuteve të Kapitullit të Katedrales së qytetit mesjetar të Drishtit. Një hapësirë e veçantë iu kushtua Urdhrit Françeskan, duke ndriçuar veprimtarinë e tij në trojet shqiptare gjatë mesjetës dhe periudhës osmane, si edhe kontributet konkrete në shek. XVII dhe

gjysmën e parë të shek. XVIII. Krahas kësaj, u shqyrtuan edhe përpjekjet e Argjipeshkvit të Tivarit, Fran Leonardi, për bashkimin (uniatizmin) me Kishën Ortodokse, të cilat pasqyrojnë dimensionin ekumenik të sfidave kishtare të kohës.



Më tej, kumtesat mbi rolin e ortodoksisë në Kosovë gjatë Mesjetës shtuan një dimension tjetër të rëndësishëm në kuadrin e pluralizmit fetar. Një pjesë e konferencës u ndal mbi arkitekturën dhe kulturën materiale fetare, ku spikati analiza e xhamisë monumentale të Sofi Sinan Pashës në Prizren me arkitekturën dhe dekoracionet e saj, si dhe shqyrtimi i fenomenit të shndërrimit të mesxhideve në xhami gjatë shekujve XVII–XVIII si tregues i procesit të islamizimit. Një vëmendje e veçantë iu kushtua strukturave shoqërore dhe elitave fetare.

Së fundi, konferenca i kushtoi hapësirë periudhës së re moderne, duke shqyrtuar lëvizjen protestante në vilajetet shqiptare nga fundi i shekullit XIX deri në fillim të shekullit XX.

Nëpërmjet gjithë këtyre tematikave, kumtuesit hodhën dritë në çështjet e identiteteve fetare dhe kulturore, ndërveprimeve ndërmjet feve dhe rolit të elitave shoqërore e shpirtërore në formësimin e jetës së komuniteteve, si dhe në fenomenin e ndërthurjeve komplekse ndërmjet fesë, kulturës dhe shoqërisë, duke kontribuar në pasurimin e studimeve historike dhe kulturore mbi trojet shqiptare dhe vendin e tyre në kuadrin e gjerë ballkanik dhe mesdhetar.

www.akad.gov.al

Kronikë për tryezën shkencore “Alfabetizime dhe kundrime të reja në albanologji”

Më 24 shtator 2025, në orën 11:00, në ambientet e Bibliotekës së Institutit të Arkeologjisë (ASHSH), Departamenti i Leksikologjisë, Terminologjisë dhe Gjuhësisë së Zbatuar organizoi tryezën shkencore me temë: “Alfabetizime dhe kundrime të reja në albanologji”.

Veprimtaria u hap nga përgjegjësi i departamentit, z. Artur Lama, i cili përgëzoi ideatoren e takimit, punonjësen shkencore znj. Rafaela Marteta, dhe vlerësoi kontributin e studiuesve T. Plangarica, E. Paci, A. Spiro dhe V. Sinanaj, cilët sollën në tryezë reflektime dhe teza të rëndësishme të trajtuara në Kongresin XIII të AIESEE-së, mbajtur në Shkup më 15–19 shtator 2025.



Në parashtresën e tij me titull “Udhëhapjet e alfabetizimeve të reja si nxitje për më shumë studime bashkëkohore”, z. Lama argumentoi se alfabetizimet e reja dhe gjuhësia përfaqësojnë një ndërthurje të rëndësishme mes zhvillimeve teknologjike, sociale dhe teorike në mënyrën si kuptojmë, mësojmë dhe përdorim gjuhën sot. Ndryshe nga alfabetizimi tradicional, që përqendrohet në aftësinë për të lexuar dhe shkruar, alfabetizimet e reja zgjerojnë pikëvështrimin dhe mundësojnë forma të ndryshme komunikimi, si dhe një larushi kompetencash gjuhësore të lidhura me kontekstin digjital, mediatik, vizual dhe kritik.

PhD (kandidate) Rafaela Marteta kumtoi me temën “Perspektiva plurale e ligjërimeve: nga gjuha në alfabetizimet e reja”. Kumtesa e saj u mbështet në

rekomandimet e Komisionit European për pjesëmarrje demokratike dhe kompetente në ambientet digjitale, duke theksuar përgjegjësinë profesionale dhe etike të specialistëve që krijojnë domene ontologjike (OWL), të cilat kërkojnë përmbajtje të strukturuar dhe të paraqitur me kompetencë të lartë gjuhësore dhe ligjërimore.



Prof. dr. Tomorr Plangarica paraqiti kumtesën “Bashkëpunimi mes studiuesve dhe institucioneve shkencore në vendet e Europës Juglindore – premisë për institucionalizimin konjitiv, intelektual dhe social më të shpejtë të dijeve dhe disiplinave shkencore”. Ai e lidhi këtë trajtesë me reflektimet e nxitura nga Kongresi XIII i AIESEE-së, përmes një problematike plotësuese të titulluar “Kongresi XIII i AIESEE-së dhe studimet në fushën e ballkanologjisë/ballkanistikës”.



Në vijim ai trajtoi tre çështje kryesore: I. Paradigma e shkencës sot nuk është vetëm fryt i talentit dhe përkushtimit individual apo të ekipeve kërkimore, por edhe i funksionimit të institucioneve që mundësojnë statusin dhe përhapjen e dijes. II. Bashkëpunimi në fushën shkencore është një mundësi për përsheptimin e institucionalizimit konjitiv dhe social të dijes. III. Bashkëpunimi përtej dijes lokale krijon mundësi për thellim, zhvillim dhe institucionalizim më të shpejtë të dijes në vendet e arealit ballkanik, veçanërisht në fushat ndërdisiplinare.

Prof. Plangarica theksoi nevojën për krijimin e një departamenti të veçantë në IGJL, të titulluar “Departamenti i Historisë së Gjuhës Shqipe dhe Ballkanistikës”, si një hap strategjik për zhvillimin e studimeve rajonale.

Prof. as. dr. Evalda Paci prezantoi kumtesën “Çështje të njohjes së elementeve përfaqësuese në veprat e letërsisë së vjetër shqipe”, paraqitur në gjuhën frënge në Kongresin XIII të AIESEE-së. Ajo analizoi veçoritë e pjesëve introductive të veprave të shekullit XVII, si ato të Pjetër Budit dhe Frang Bardhit, duke i krahasuar me tekste paraardhëse, përfshirë kolofonin e “Mesharit” të Buzukut. Sipas saj, këto tekste ndihmojnë në konfigurimin më të qartë të rrugëtimit historik të veprave dhe në lidhjen e tyre me zhvillimet e kohës. Paci u ndal edhe në historikun e simpoziumeve dhe kongreseve të mëparshme të AIESEE-së, ku janë trajtuar tema mbi letërsinë e krahasuar, toposet dhe qytetërimin ballkanik, si dhe dëshmitë më të hershme shkrimore të gjuhëve të rajonit.



Prof. as. dr. Aristotel Spiro kumtoi me temën “Bregat filologjike të motrës së Kostandinit të vdekur në udhëtimin e saj përmes tri gjuhëve – Kënga e Garentinës”. Ai argumentoi se kjo këngë dëshmon jo vetëm kontaktet kulturore mes shqiptarëve dhe

grekëve, por edhe evolucionin fonetik të shqipes së vjetër, si pasojë e kontakteve me greqishten dhe italishten, pas emigrimit të arbëreshëve drejt Italisë së Poshtme. Sipas tij, pasqyrimi filologjik i folklorit ndikon në errësimin e veçorive fonetike dhe në riinterpretimin fonologjik të lëndës gjuhësore.

Dr. Valbona Sinanaj prezantoi kumtesën “Dygyhësia – mundësi kontaktesh gjuhësore, sociale dhe kulturore të ndërsjella”. Ajo theksoi se prania e gjuhëve të ndryshme në një komunitet mundëson ndërveprim të vazhdueshëm, duke sjellë ndryshime jo vetëm gjuhësore, por edhe kulturore e sociale. Dygyhësia, sipas saj, paraqet një sfidë për t’u eksploruar në të gjitha këto dimensione.



Akad. prof. dr. Valter Memisha dhe prof. dr. Artur Lama paraqitën kumtesën “Përqasje etnokulturore në frazeologjinë e popujve ballkanikë”. Autorët vlerësuan veprën Fjalori frazeologjik ballkanik (1999), botuar nga IGJL (ASHSH), si fjalori i parë shumëgjuhësh në leksikografinë shqiptare dhe një pasuri të vyer etnogjuhësore. Ata analizuan frazeologjizmat sipas qasjeve semantike, etnolinguistike dhe semiotike, duke u ndalur te dukuritë tekstuale, imagjinare, simbolet kulturore, aspektet e kulturës materiale dhe ndërveprimi social i bazuar në kulturë.

Tryeza u mbyll me diskutime dhe propozime për krijimin e njësisë të reja shkencore, në kuadër të reformimit dhe perspektivës së Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë për vitet në vijim.

Filloi punimet Kongresi i 13-të i Studimeve të Europës Juglindore në Shkup



Sot, më 15 shtator 2025, ka nisur punimet kongresi i 13-të i Association Internationale d'Études du Sud-Est Européen – AIESEE-së në Shkup me temën “Komunikimi dhe shkëmbimet: Europa Juglindore në kuadër të proceseve globale sociale, politike dhe kulturore”.

Punimet e këtij kongresi zhvillohen në ambientet e Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve në Shkup dhe do të vijojnë deri më 19 shtator 2025.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë përfaqësohet me 11 pjesëmarrës, akademikë e studiues të instituteve të albanologjisë e më gjerë, të cilët u përzgjodhën nga komiteti kombëtar shqiptar i AIESEE-së, që funksionon pranë ASHSH-së.

Ky kongres synon shkëmbimin e dijeve dhe njohurive shkencore mbi Europën Juglindore në komunitetin e gjerë akademik, ndarjen e njohurive për ndërtimin institucional, trajtimin e çështjeve të emigracionit, historiografisë dhe kujtesës në proceset shoqërore dhe kulturore të Europës Juglindore e më gjerë.

Kongresi i AIESEE-së organizohet nga Shoqata Ndërkombëtare e Studimeve për Europën Juglindore (Association Internationale d'Études du Sud-Est Européen – AIESEE), e themeluar në vitin 1964 me propozim e nismë të UNESCO-s.

Nisi shkolla ndërkombëtare e trajnimit me temën "Nxitja e biosipërmarrjes në bioteknologji"

Veprimtaria me temën "Training school: Fostering bioentrepreneurship in biotechnology" nisi më 8 shtator 2025 me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në kuadër të projektit "BioSensToxicWater 2025-2027".

Kjo veprimtari do të vijojë edhe në datat 9 e 10 shtator 2025.



Programi i trajnimit u drejtua nga prof. dr. Robert Marks nga Universiteti "Ben Gurion i Negev", Izrael, dhe prof. dr. Ariola Bacu, drejtuese e projektit të ASHSH-së.

Trajnimet lidhen me vlerësimin e kujdesshëm të ideve të studentëve në lëndën "Hyrje në biosipërmarrje" në panelin e mentorëve: Adam Mechler, Mark Nuijten; dhe asistentëve: Gal Carmeli, Fred Narcross.

Prof. dr. Ariola Bacu përshëndeti pjesëmarrësit dhe hapi sesionin e parë të workshop-it me studentët, i cili zhvillohet pas finalizimit të dispozitivave të tyre.

Prof. Robert Marks paraqiti objektivat e këtij workshop-i dhe më pas studentët vijuan prezantimet duke iu përgjigjur pyetjeve të ekspertëve: Yael Mali (online) Izrael, Mark Nuijten (Holandë), Robert Marks (Izrael), Adam Mechler (Australi).

Në sesionin e dytë u bë vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve. Studentët i paraqitën projektet e tyre deri në 5 diapozitiva. Projektet e pranuar do të mbështeten gjatë vijimit të punës.



Pas përzgjedhjes së projekteve, studentët u orientuan për arritjen e objektivave, menaxhimin dhe procesin e udhëheqjes së punës nga dr. Yael Mali (Menaxher i marketingut dhe BD), Savyon Diagnostics Ltd, dhe prof. Adam Mechler.

www.akad.gov.al

Vijon shkolla ndërkombëtare e trajnimit me temën "Nxitja e biosipërmarrjes në bioteknologji"

Sot, më 9 shtator 2025, vijoi dita e dytë e shkollës ndërkombëtare të trajnimit për nxitjen e biosipërmarrjes në bioteknologji.

Kjo veprimtari zhvillohet me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nën drejtimin e prof. dr. Robert Marks (Universiteti "Ben Gurion i Negev", Izrael) dhe prof. dr. Ariola Bacu, drejtuese e projektit "BioSensToxicWater 2025-2027".

Veprimtaria u çel me prezantimin e punimit "Gjurmët: Një mjet i ri rrjetëzimi" nga Fred Narcross-i.



Gal Carmeli paraqiti punimin me temën "Zbatimet dhe potenciali i komercializimit të një biosensori me fibër optike të shpërndarë për monitorimin e toksicitetit në ujë dhe sedimente (SUNDANSE)".

Më tej, vijuan trajnimet e studentëve për detajimin e gjashtë projekteve mbi produktet e bioteknologjisë me aplikime në mjekësi.

Profesorët që drejojnë shkollën: Yael Mali (online) Izrael, Mark Nuijten (Holandë), Robert Marks (Izrael), Adam Mechler (Australi), i orientuan studentët në aspekte të specifikave teknike, atyre të tregut e marketingut e më gjerë.

Shkolla ndërkombëtare e trajnimit nisi më 8 shtator 2025 dhe do të mbyllet më 10 shtator 2025.

www.akad.gov.al

U përmbyll me sukses shkolla ndërkombëtare e trajnimit

-U përzgjodhën dhe u zhvilluan 5 ide inovatore nga studentët: Alesia Brunga, Alkea Braho, Denada Bozhiqi, Ersi Qazolli e Iljan Lati-



Sot më 10 shtator 2025 u zhvillua dita e tretë e shkollës ndërkombëtare të trajnimit për nxitjen e biosipërmarrjes në bioteknologji ("Training school: Fostering bioentrepreneurship in biotechnology").

Shkolla e trajnimit , e cila nisi më 8 shtator 2025, u mbështet nga Projekti BiosenstoxicWater-2025, i drejtuar nga prof. dr. Ariola Bacu (ASHSH) dhe a prof. dr. Robert Marks (Universiteti "Ben Gurion of Negev, Izrael).

Gjatë tri ditëve, ekspertët Yael Mali (Izrael), Mark Nuijten (Holandë), Robert Marks (Izrael), Adam Mechler (Australi) dhe asistentët Gal Carmeli e Fred Narcross dhanë orientime dhe vlerësime për projektet e studentëve në lëndën "Hyrje në biondërmarrje".

Në përfundim të kësaj veprimtarie u përzgjodhën dhe u zhvilluan pesë ide inovatore, qe premtojnë zhvillim të mëtejshëm në fushën e biznesit nga studentët: Alesia Brunga, Alkea Braho, Denada Bozhiqi, te programit Master Shkencor ne Bioteknologji dhe Ersi Qazolli e Iljan Lati në programin "Bioentrepreneurship in biotechnology" .



Ky projekt financohet nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe realizohet në bashkëpunim nga Universitetin e Tiranës Departamentin e Bioteknologjisë, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Vlorës, dhe Universitetin Ben Gurion të Negevit në Izrael.

www.akad.gov.al

Ditë informimi mbi programet e projekteve kombëtare

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), organizoi veprimtarinë me temën “Ditë informimi mbi programet e projekteve kombëtare që financohen nga Agjencia”.

Takimin e hapi drejtorja e Qendrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në Akademinë e Shkencave, prof. dr. Enika Abazi.



Pasi përshkroi bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve dhe bëri një pasqyrim të projekteve të financuara nga AKKSHI dhe të zbatuara nga Akademia, prof. dr. Abazi i dha fjalën znj. Marsela Robo, drejtore e Drejtorisë së Programeve Kombëtare.



Znj. Robo bëri një paraqitje për mënyrën dhe kushtet e aplikimit në programet kombëtare, veçanërisht për programin e projekteve kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit (PKKZH).



Gjithashtu, ajo iu përgjigj edhe një sërë pyetjesh të bëra nga pjesëmarrësit në këtë ditë informimi, duke bërë të mundur sqarimin e disa çështjeve, të cilat hasen gjatë fazave të projektit, duke filluar me aplikimin dhe deri te raportimi i fundit.

www.akad.gov.al

Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare

Akademik Gëzim Hoxha merr pjesë në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare të Studimeve Ballkanike në Universitetin Sllav të Baku-së, Azerbajxhan

Konferenca e Dytë Ndërkombëtare e Studimeve Ballkanike u zhvillua më 26 shtator 2025, në Universitetin Sllav të Baku-së (BSU), me pjesëmarrjen e personaliteteve akademike e shkencore nga vende të ndryshme të Botës.



Akademik Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ka marrë pjesë në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare të Studimeve Ballkanike në Universitetin Sllav të Baku-së.

Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Hoxha mbajti fjalën përshëndetëse me temën "Perspektivat e bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Universitetit Sllav të Baku-së". Ai theksoi angazhimin e palëve për ndërtimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe të frytshëm në fushën e shkencës dhe arsimit ndërmjet Shqipërisë dhe Azerbajxhanit, me fokus të veçantë nxitjen dhe zhvillimin e studimeve të gjuhës shqipe në kontekstin shumë të pasur linguistik të vendeve të Ballkanit.

Fjala e plotë:

E nderuar kryesi e konferencës, të dashur kolegë dhe pjesëmarrës,
Është një nder dhe kënaqësi e veçantë për mua të përfaqësoj Akademinë e Shkencave të Shqipërisë në këtë konferencë, e cila ka për qëllim krijimin e një platforme të gjallë për dialog shkencor dhe shkëmbim kritik mbi studimin dhe mësimdhënien e gjuhëve dhe letërsive ballkanike.

Rajoni ynë, me shumëllojshmërinë e tij gjuhësore, kulturore dhe historike, mbetet një laborator i pasur për kërkime ndërdisiplinore, ku ndërthuren traditat e lashta me sfidat bashkëkohore. Republika e Shqipërisë është palë nënshkruese dhe ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare që promovojnë bashkëpunimin multietnik dhe garantojnë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, qoftë ajo materiale apo jomateriale. Pikërisht për këtë arsye, angazhimi ynë i përbashkët për të bashkëpunuar në kuadër të shkencave shoqërore, si në nivel teorik ashtu edhe në atë empirik, merr një rëndësi të veçantë.



Kërkimet bashkëkohore në shkencat sociale në Ballkan kanë një mision të dyfishtë. Nga njëra anë, të kuptojnë më thellë proceset historike dhe kulturore që na kanë formuar. Nga ana tjetër, të japin përgjigje ndaj dinamikave të reja të shoqërisë. Të tilla janë: migracionet, transformimet urbane, dialogu ndërkulturor, si dhe roli i gjuhës dhe i identitetit në ndërtimin e hapësirave të përbashkëta europiane. Këto kërkime jo vetëm që pasurojnë njohjen tonë akademike, por gjithashtu kontribuojnë në forcimin e kohezionit social dhe të bashkëpunimit rajonal.

Akademia jonë bashkëpunon veçanërisht me katedrat e gjuhës shqipe në universitetet e Napolit, Mynihut, Beogradit dhe Pekinit, si edhe me një numër

studiuesish të gjuhësisë indoevropiane që merren me këtë gjuhë të lashtë të Ballkanit. Aktualisht, jemi në fazën përfundimtare të një projekti madhor shkencor: hartimi i "Fjalorit të madh të gjuhës shqipe".



Në këtë atmosferë bashkëpunimi, më 7 prill 2025, patëm nderin të presim në një vizitë në Akademinë së Shkencave të Shqipërisë rektorin e Universitetit Sllavistik të Baku-së, prof. dr. Anar Naghiyev; ambasadorin të Republikës së Azerbajxhanit në Republikën e Shqipërisë, z. Anar Huseynov, si dhe anëtarët e tjerë të delegacionit. Në këtë takim u shpreh angazhimi i palëve për ndërtimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe të frytshëm në fushën e shkencës dhe të arsimit në Shqipëri dhe në Azerbajxhan, me fokus të veçantë nxitjen dhe zhvillimin e studimeve të gjuhës shqipe në kontekstin shumë të pasur linguistik të vendeve të Ballkanit.

Jam i bindur se kjo konferencë do të shërbejë jo vetëm si hapësirë reflektimi dhe debati mbi problematikat dhe arritjet në fushën tonë, por edhe si urë bashkëpunimi për të ndërtuar projekte të reja, të dobishme për komunitetin akademik ndërkombëtar.

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për organizatorët dhe të uroj që punimet tona të sjellin fryte të vlefshme për shkencën dhe për ndërlidhjen e traditave akademike në hapësirën ballkanike dhe më gjerë.

Ju faleminderit dhe ju uroj punë të mbarë!

www.akad.gov.al

Studiuesja e Qendrës së Studimit të Arteve, dr. Anxhela Çikopano, mbajti diskutimin publik: "Realitete artistike: një film për komunizmin në Shqipërinë jo-komuniste"



Të premten, më 19 shtator, në kuadër të Festivalit të Filmit e Kulinarisë në Pogradec, në bashkëpunim edhe me Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, studiuesja e Qendrës së Studimit të Arteve, dr. Anxhela Çikopano, mbajti diskutimin publik: "Realitete artistike: një film për komunizmin në Shqipërinë jo-komuniste", ku pas shfaqjes së filmit me metrazh të shkurtër "Një histori e parrëfyer", ku dr. Çikopano ka rolin e skenaristes, solli përvojën personale të shkrimit për realitetin komunist, krahasuar me filma të realizuar gjatë epokës komuniste, që trajtojnë tematika të ngjashme me ato të këtij filmi, duke përballur realitete të ndryshme artistike, që kanë si burim të njëjtin realitet jetësor, por që zhvillohen në kuadro të ndryshme ideologjike. Gjatë bisedës, ajo prezantoi publikun edhe me koncepte të reja, të lëvruara vitet e fundit nga studiuesit e Qendrës së Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave në fushat e artit dhe iu përgjigj pyetjeve e komenteve të publikut shqiptar e të huaj, që qe i pranishëm në sallë.

Prof. asoc. dr. Roven Vata Mikeli, mori pjesë në Seminarin XIX Ndërkombëtar të Albanologjisë & Panairi Mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor me temë bosht: “Dialogu kulturor mes letërsisë shqipe dhe asaj botërore”

Më datë 25 shtator 2025, prof. asoc. dr. Roven Vata Mikeli, punonjëse shkencore e Departamentit të Studimeve Letrare, pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, mori pjesë në Seminarin XIX Ndërkombëtar të Albanologjisë & Panairi Mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor me temë bosht: “Dialogu kulturor mes letërsisë shqipe dhe asaj botërore”, i organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, Maqedoni e Veriut.



Prof. asoc. dr. Roven Vata Mikeli u paraqit me kumtesën me titull: “Figura e gruas në krijimtarinë poetike të Dritëro Agollit”. Më poshtë po paraqesim një përmbledhje të kësaj kumtese:

Dritëro Agolli ishte poet, prozator, publisist dhe politikan shqiptar. Krijimtaria e tij letrare është mjaft e pasur në gjini e lloje të ndryshme: poezi, poema, tregime, novela, romane, drama, skenarë filmash, etj., në të cilën kryesisht mbizotërojnë ndjenjat e njeriut, traditat, patriotizmi, familja, etj.

Një fokus të veçantë Dritëro Agolli ia kushtoi edhe figurës së gruas, e cila sipas tij, nuk kishte zënë një vend meritore në letërsinë shqipe, pasi që trimëritë e burrave kishin mbuluar sakrificën e grave dhe nënave përgjatë rrugëtimit të vështirë historik.

Figura e gruas në veprimtarinë poetike të Dritëro Agollit personifikohej përmes nënës, motrës, vajzës, të dashurës, shoqes, mikes, mbesës, gjyshes, gruas dhe mbarë femrës shqiptare. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është që të shtjellohet perceptimi i Dritëro Agollit ndaj personifikimeve të përmenduara më sipër. Figura e femrës trajtohet në disa aspekte: social, kulturor, psikologjik, historik, etno-foklorik, poetik dhe estetik. Si rezultat mund të themi se për Dritëro Agollin figura e gruas shërbente si muzë frymëzuese, duke përplotësuar estetikisht elementin e bukurisë, të mirësisë dhe të virtyteve më të larta shoqërore dhe njerëzore.

Dritëro Agolli gratë shqiptare i krahason me hyjnitë, duke veçuar tek ato dy cilësi kryesore: vullnetin dhe mençurinë.

**Prof. asoc. dr. Roven Vata Mikeli, mori pjesë në Konferencën Shkencore
“Dritëhije” IV**



Më datë 26 shtator 2025, prof. asoc. dr. Roven Vata Mikeli, punonjëse shkencore e Departamentit të Studimeve Letrare, pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, mori pjesë në Konferencën Shkencore “Dritëhije” IV, e cila u mbajt në përputhje me temën e Ditëve Europiane të Trashëgimisë dhe në kuadër të programit “Viti Maks Velo”, ku tema bosht e kësaj konference ishte: “Trashëgimia dhe Arkitektura: Dritare në të kaluarën, Dyer për të Ardhmen”, e organizuar nga Muzeu Kombëtar i Përgjimeve: “Shtëpia me Gjethe”, Tiranë.

Prof. asoc. dr. Roven Vata Mikeli u paraqit me kumtesën me titull: “Modernizmi në zinxhirë: Maks Velo dhe shteti totalitar”, ku po paraqesim një përmbledhje të kësaj kumtese:

Data 7 maj e vitit 2025 shënoi 5 vjetorin e ndarjes fizike të Maks Velos nga jeta tokësore. Në përvjetorin e pestë të largimit të tij, që përkon edhe me shpalljen e vitit 2025 si viti i Maks Velos, njerëz të nderuar të vendit tonë, me theks të veçantë nga fusha e artit, kulturës e publicistikës, përpiqen të lartësojnë emrin dhe figurën e tij artistike, duke shprehur mendime për veprat e tij apo duke treguar, sesi ishte Maksi, njeri, artist, shok, koleg e mik.

Shprehja antropologjike: “Ne rritemi drejt vdekjes” dhe mentaliteti i popullit shqiptar që “Pasi vdesim na lavdërojnë” i shkon më së miri përshtat artistit modernist Maks Velo, krijimtaria artistike e të cilit, nuk ka studime të konsiderueshme.

Artisti modernist, Maks Velo ishte intelektual, arkitekt, piktor, kritik arti, analist, publicist, shkrimtar. Velo i dashuronte ngjyrat në artin e tij, lexonte literaturë në disa gjuhë evropiane, shijonte artistët botërorë, përmes leximeve dhe meditimit, ashtu siç dinte të bënte vetëm një mendje e lirë, e një artisti të madh, të një vendi të vogël.

Fuqia magjike e pikturave me ngjyra dhe kërkimet psikologjike në karakterin e imazheve, janë risi, vlerë dhe kontribut për pikturën shqiptare, së cilës falë durimit, punës dhe guximit të tij, i hapi rrugën drejt ngjasimit me pikturat evropiane, teksa shprehim bindjen se në pikturë, Maks Velo ishte Picaso shqiptar.

Ai në jetën e tij artistike pikturoi me shijen e frymës moderne dhe projekttoi si arkitekt me sharmin e modeleve evropiane, por edhe jetoi e krijoi art në një periudhë të vështirë për shumë artistë.

Puna e tij si arkitekt është e lidhur me projektimin e disa ndërtesave publike, shoqërore dhe kulturore, ku veprat e tij i përkasin objekteve publike, si: Kinemaja e ish Pallatit të Pionierëve-Tiranë; ish ATSH (Bulevardi “Zogu i I”); Hotel Arbana (sot Drejtoria e Përgjithshme e Policisë); etj.

Në fushën e arkitekturës Maks Velo është i njohur si projektuesi dhe arkitekti i Pallatit me Kuba, pallati modern, në mes të kryeqytetit, i cili u bë shumë shpejt i lakmueshëm për të jetuar në mjediset e tij sa moderne dhe fine, aq edhe të diskutueshme nga sistemi politik i kohës. Figura e tij personale dhe artistike pashmangshëm është e ndërlidhur me shtetin totalitar. Të qenët brenda shtetit totalitar, i cili kishte në shënjestër artistët, e në veçanti artin e tyre, që nuk përputhej me ideologjinë e kohës, Maks Velo u kritikua rëndë dhe u dënua me burg, ku shkak u bë krijimtaria e tij artistike. Ishte pikërisht Plenumi i IV-të i KQ të PPSH, i cili kritikoi Maks Velon për ndikime të huaja në krijimtarinë e tij prej artisti.

Maks Velo arrestohet dhe dënohet me 10 vite burg në kampet e tmerrshme të Spaçit, ku as burgu nuk ia “mbyti” frymëzimin e krijimtarisë së tij artistike, por ai gjithnjë frymëzohej nga ngjarje njerëzore reale të jetuara dhe të përjetuara, e ku më pas i ngriti të gjitha në art, me vlera dhe peshë emocionale dhe shpirtërore, disa në letërsi dhe pjesën më të madhe në pikturë, ku niveli i tyre artistik dhe estetik ishte në lartësinë e një artisti modern të arrirë. Maks Velo u dënua për artin pikturat dhe projektet e tij në arkitekturë.

E gjithë pasuria e mendimit të Maks Velos e lënë në formë rrëfimesh apo shkrimesh për pikturën, arkitekturën, letërsinë, publicistikën, zhvillimet politike dhe shoqërore, për shtetin totalitar dhe qeverisjen e pas viteve 1990, e deri sa ai mbylli sytë, përbëjnë një thesar të çmuar, të cilat do t’i shërbejnë studimeve shqiptare, si copëza elementesh për të zbërthyer një individ, i cili shkatërrohet dhe shpërbëhet nga shteti totalitar, dhe sesi, po ky individ e gjen forcën brenda vetvetes për t’u ringritur, për t’u ribërë, për t’u identifikuar dhe për t’u vendosur në radhën e më të mirëve, i cili edhe

pse kishte talent të lindur, ai i besonte vetëm punës. Puna për të ishte e vetmja mënyrë për të mos e humbur dinjitetin.

Prof. as. dr. Roven Vata Mikeli, mori pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Çështje të gjuhës, letërsisë dhe përkthimit letrar”



Më datë 29 shtator 2025, prof. as. dr. Roven Vata Mikeli, punonjëse shkencore e Departamentit të Studimeve Letrare, pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (Akademia e Shkencave e Shqipërisë), mori pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Çështje të gjuhës, letërsisë dhe përkthimit letrar”, e organizuar nga Fakulteti i Filologjisë, Universiteti “Fehmi Agani”, Gjakovë-Kosovë.

Prof. asoc. dr. Roven Vata Mikeli u paraqit me kumtesën me titull: “Dukuri estetiko-letrar në poezinë e Dritëro Agollit, rasti i vëllimit me poezi: ‘Vjen njeriu i çuditshëm’”, ku po paraqesim një përmbledhje të kësaj kumtese:

Në vëllimin me poezi: “Vjen njeriu i çuditshëm” të shkrimtarit Dritëro Agolli gjejmë një gërshetim të dukurive apo elementeve estetiko-letrare, të cilat veshin në mënyrë artistike poezinë e poetit tonë.

Në këto poezi analiza letrare do të fokusohet në dukuritë më specifike, të cilat janë: dukuritë estetike, koncepti i kohës, i jetës, i vdekjes, si dhe linja filozofike.

Estetika në këtë vëllim poetik është një përzierje e realizmit brutal, e groteskut dhe e simbolizmit të thellë. Ajo krijon një portret të errët dhe kritik të jetës së përditshme njerëzore, ku njerëzit, të shtyrë nga dëshirat e tyre materiale dhe instiktive, lëvizin në një kaos të pakuptimtë dhe të pamëshirshëm.

Një tjetër dukuri e dukshme në këtë vëllim është edhe ironia filozofike, e cila është një element estetik, që mbizotëron në këto poezi. Ajo na kujton se rastësitë dhe

absurditeti janë pjesë e pandashme e jetës njerëzore dhe se shpesh, pavarësisht përpjekjeve tona për të kuptuar, disa gjëra ndodhin thjesht, sepse duhet të ndodhin.

Koncepti i kohës në këtë vëllim poetik është një përzierje e fuqishme e melankolisë, e reflektimit dhe e dhimbjes. Koha nuk është një ide abstrakte, por një përvojë e drejtpërdrejtë, që lë gjurmë përmes tymit, përmes hirit dhe pluhurit, duke përfaqësuar kujtimet, përvojat dhe humbjet e jetës.

Ndërsa nocionin e vdekjes autori e përçjell si një proces të pandërprerë dhe të padukshëm, që ndodh brenda nesh që nga lindja.

Prof. as. dr. Evalda Paci, mori pjesë në konferencën shkencore “Transformimet dhe zhvillimi i qendrave urbane në trevat shqiptare gjatë Antikitetit të vonë dhe Mesjetës”



Më datën 26 shtator 2025, prof. as. dr. Evalda Paci, përgjegjëse e Departamentit të Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, mori pjesë në konferencën shkencore “Transformimet dhe zhvillimi i qendrave urbane në trevat shqiptare gjatë Antikitetit të vonë dhe Mesjetës”, organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë dhe Departamenti i Historisë pranë Fakultetit Filozofik (Universiteti i Prishtinës). Evalda Paci u paraqit me temën “Burime e të dhëna dokumentare mbi figura të rëndësishme të historisë kishtare të shekullit XVII”, në të cilën trajtoi çështje të evidentimit të të dhënave me rëndësi historike dhe kulturore në relacionet e misionarëve të shekullit XVII, një pjesë e të cilave janë risjellë dhe së fundmi në numrat përkatës të revistës “Studime filologjike”, nën kujdesimin e studiueses Lucia Nadin. Gjurmimi i emërtimeve mbi ndarje të caktuara administrativo-kishtare në vëllimet dokumentare të shekujve të mëhershëm (Illyricum Sacrum, Tomus Septimus, auctore Daniele Farlato, Venetiis, MDCCCXVII), por dhe krahasimi përkatës në pjesë të veçanta të veprave të letërsisë së vjetër shqipe (ndër të tjera dhe në kapituj të Dictionarit të Frang Bardhit, Romë, 1635) përbën dhe një orientimeve të trajtimit në këtë kumtesë.

Prof. as. dr. Evalda Paci, mori pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare me tematikë “Çështje të gjuhës, letërsisë dhe përkthimit letrar”

Më datën 29 shtator 2025, prof. as. dr. Evalda Paci, përgjegjëse e Departamentit të Studimeve Letrare pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (Akademia e Shkencave e Shqipërisë) mori pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare me tematikë “Çështje të gjuhës, letërsisë dhe përkthimit letrar”, të organizuar nga Fakulteti i Filologjisë së Universitetit “Fehmi Agani” të Gjakovës, në bashkëpunim me disa institucione të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të trevave shqipfolëse. Në fjalën e saj përshëndetëse, Evalda Paci nënvizoi rëndësinë e organizimit të veprimtarive shkencore ndërinstitutionale, përmes të cilave përforcohet dhe bashkëpunimi mes institucioneve akademike kërkimore dhe atyre të mësimdhënies universitare, mbështetet gjithashtu dhe konsolidimi i kurrikulave universitare dhe pasuniversitare me orientim disiplinat themelore të studimeve në gjuhësi, letërsi, antropologji dhe shkencën e përkthimit.



Po në këtë konferencë, në seancën kushtuar studimeve letrare dhe prurjeve studimore mbi letërsinë shqipe, Evalda Paci mbajti kumtesën me titull “Çështje të autorësisë dhe të autoritetit shkrimor në vepra të letërsisë së vjetër shqipe”, në të cilën u trajtuan elemente të njohjes dhe të evidentimit të veprave të letërsisë së vjetër shqipe në studimet letrare shqiptare, por dhe të pasqyrimin në katalogë dhe regeste bibliotekash të shekullit XVII-XVIII, të përpiluar në gjuhën latine dhe me një përmbajtje të dhënash mbi autorët dhe përpiluesit e tyre.

Marrëveshje bashkëpunimi

U nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Shoqatës Europiane të Rrjetit Tematik të Bioteknologjisë (EBTNA)

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi dhe prof. dr. Oscar Vicente Mana, zëvendës-president i EBTNA-s, sot më 11 shtator 2025, nënshkruan marrëveshjen për anëtarësim institucional dhe bashkëpunimin ndërmjet Shoqatës Europiane të Rrjetit Tematik të Bioteknologjisë (EBTNA-European Biotechnology Thematic Network Association) dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH).



Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është formalizimi i anëtarësimit institucional të ASHSH-së në EBTNA dhe krijimi i një kuadri strategjik bashkëpunimi në fushat e bioteknologjisë, shkencave të jetës, arsimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar shkencor.

Si anëtar institucional, Akademia e Shkencave e Shqipërisë do të ketë përfaqësim në Asamblenë e Përgjithshme të EBTNA-s dhe do të gëzojë të drejta të plota për të marrë pjesë në iniciativat e saj.

ASHSH-ja do të mbështesë misionin e EBTNA-s dhe do të kontribuojë në qëllimet e saj shkencore dhe akademike, duke përfshirë edhe koordinimin lokal dhe mbështetjen institucionale.

Sipas marrëveshjes, palët do të bashkëpunojnë në organizimin dhe promovimin e përbashkët të ngjarjeve shkencore, përfshirë kongreset, workshop-et, simpoziumet dhe leksionet publike, aktivitetet sociale dhe akademike, pjesëmarrjen në rrjete

kërkimore europiane dhe ndërkombëtare dhe projekte bashkëpunimi të koordinuara nga EBTNA e më gjerë.



Ceremonia u mbajt në kuadër zhvillimeve të Kongresit Europian të Bioteknologjisë 2025, të organizuar nga EBTNA, i cili mbahet për herë të parë në Shqipëri me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në datat 11-13 shtator 2025.

Në këtë kongres marrin pjesë rreth 200 kërkues, lektorë, përfaqësues të industrive (ushqimore, farmaceutike, mjekësore), studentë të profileve të ndryshme, që kanë objektiv të studimit të tyre drejtimet e bioteknologjive mjekësore, farmaceutike, mjedisore, bujqësore, industriale, shtazore, akuakulturë etj., nga vende të Bashkimit Europian, vende të Ballkanit Perëndimor, Kanadaja, Izraeli, Australia, Kina etj.

www.akad.gov.al

Takime

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi pret në një vizitë zyrtare ambasadorin e Spanjës në Shqipëri z. Gabriel Cremades Ventura

Kryetari i ASHSH-së akad. Gjinushi priti sot në një takim kortezie ambasadorin e Mbretërisë së Spanjës në Shqipëri, z. Gabriel Cremades Ventura. Pjesëmarrës në takim ishin: Sekretarja shkencore akad. Anila Hoda, kancelari Ruzhdi Kuçi dhe shefja e marrëdhënieve me jashtë dhe publikun prof. asoc. dr. Elda Zotaj.



Kryetari i ASHSH-së akad. Gjinushi në fjalën e tij e njohu ambasadorin me strukturën, vizionin dhe proceset reformuese që ka pësuar Akademia e Shkencave vitet e fundit. Ai u ndal në hapjen e Akademisë drejt bashkëpunimeve me institucionet kërkimore-shkencore në Europë dhe më gjerë, si dhe në krijimin e mundësive për shkencëtarët shqiptarë që janë jashtë vendit për t'u bërë pjesë e saj.

Në kuadër të bashkëpunimeve me Ambasadën e Spanjës, kryetari Gjinushi solli në vëmendje veprimtarinë e parë të nisur 20 vjet më parë përmes mbështetjes që ajo dha në organizimin e workshop-it të parë në fushën e biosensorëve. Bashkëpunimet mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me institucionet kërkimore në Spanjë vijuan me krijimin e Qendrës së Nanoteknologjisë pranë ASHSH-së, me mbështetjen nga ICN2 (Catalan Institute of Nanoscience and Nanotechnology).

Akad. Gjinushi përmendi faktin se në radhët e anëtarëve të nderit kemi dhe profesorin spanjoll Jose Manuel Floristan, i cili ka kryer studime për historinë e mesjetës

së vonë shqiptare, duke dhënë kontribut shkencor edhe në trajtimin e marrëdhënieve shqiptaro-spanjolle në shek. XV-XVII. Ai përmendi edhe bashkëpunime të tjera të rëndësishme, si Konferenca Ndërkombëtare e Nanoteknologjisë, e cila zhvillohet prej pesë vjetësh në Tiranë edhe me mbështetjen e Ambasadës së Spanjës.



Ambasadori Cremades, duke falënderuar kryetarin akad. Gjinushi për pritjen dhe duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm, u shpreh i gatshëm që ambasada do të vijojë të luajë një rol proaktiv dhe nxitës për krijimin e mundësive të partneritetit mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademive Spanjolle të fushave të ndryshme. Pavarësisht nga ndryshimet strukturore që ekzistojnë mes akademive të dy vendeve, ambasadori tha se ka hapësira që të ndërmerren nisma të përbashkëta. Ai vuri theksin në forcimin e bashkëpunimit dhe mbështetjen e Spanjës për Shqipërinë në të gjitha fushat, veçanërisht në procesin e integrimit të saj në Bashkimin Europian.

Të dyja palët shprehën interesin për forcimin e marrëdhënieve me Ambasadën e Spanjës bazuar në bashkëpunimin ekzistues, si dhe në kuadër të nismave të reja që mund të ndërmerren në të ardhmen.

www.akad.gov.al

Sopranoja e shquar me famë botërore, Ermonela Jaho, merr diplomën si “Anëtare e jashtme” e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Sot, më 22 shtator 2025, sopranoja me famë botërore Ermonela Jaho u prit në selinë e Akademisë së Shkencave nga kryetari i ASHSH-së akad. Skënder Gjinushi; zv/kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, znj. Evis Kushi; zëvendëskryetari i ASHSH-së, akad. Vasil Tole; sekretarja shkencore e ASHSH-së akad. Anila Hoda; anëtarë të tjerë të kryesisë së ASHSH-së, akademikë, të ftuar dhe miq të saj.



Mikpritja nisi me falënderimet dhe shprehjen e mirënjohjes nga Kryetari i Akademisë së Shkencave për arritjet e sopranos së shquar në skenat e operës botërore.

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil Tole, bëri një prezantim të përmbledhur të vlerave dhe meritave të sopranos Ermonela Jaho. Pasi përshkoi rrugëtimin e saj artistik dhe sukseset e panumërta në skenat botërore, akad. Tole theksoi se interpretimet e saj operistike përfshijnë kryerole, si: Violetta te “La traviata”, -Çio Çio Sian te “Madame Butterfly”, Manon tek opera “Manon”, Amina te “La sonnambula”, Mimi te “La bohème”, Michaela te “Carmen”, Giulietta tek “I Capuleti e i Montecchi”, Angelica te “Suor Angelica”, Norina te opera “Don Paskuale”, Suzanën te “Dasma e Figaros”, roli i Semiramidës tek opera “Semiramida”, të Mimit tek “Anna Bolen”, Thais te “Luisa Miller”, Margerita te “Faust”, rolin e Lucias te “Lucia di Lamermoor” etj.

Gjithashtu, akad. Tole vuri në dukje morinë e çmimeve ndërkombëtare që ka

fituar sopranoja e mirënjohur, si dhe skenat prestigjioze ku ajo ka kënduar duke u cilësuar si sopranoja më e vlerësuar në botë, si një engjëll i zjarrtë; si një fenomen i pandalshëm dhe sipas "Financial Times": "Ajo jep zemrën dhe shpirtin kur këndon." etj.



Në fund, ai theksoi se Ermonela Jaho, e formuar në shkollën shqiptare të kantos, është sot pa dyshim artistja më e madhe lirike shqiptare që ka arritur nivele të tilla të karrierës artistike në vijim të traditës së çelur në skenat ndërkombëtare nga Tefta Tashko Koço, Inva Mula etj.

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Gjinushi e njohu sopranon me arsyen e vendosjes së statusit të anëtarit të jashtëm, si një nevojë për hapjen e ASHSH-së ndaj studiuesve, kërkuesve e krijuesve më të suksesshëm që e ushtrojnë veprimtarinë jashtë vendit në fushën e shkencës, letërsisë, artit e kulturës; si një detyrim për të vlerësuar e shprehur mirënjohjen ndaj më të shquarëve.

Akad. Gjinushi, pasi e përgëzoi edhe njëherë sopranon për arritjet e saj, tha se Akademia e Shkencave është e nderuar me pranimin e Ermonela Jahos si anëtare jashtme.

Sopranoja e mirënjohur Ermonela Jaho shprehu mirënjohjen për Kryesinë e ASHSH-së dhe anëtarët e saj. Ajo e konsideroi vlerësimin si anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë si një nder që shkon përtej një vlerësimi formal. "Është një prekje shpirtërore, një rikthim simbolik në origjinë, një urë që lidh rrugëtimin

tim artistik me vendin që më dha frymën e parë”-tha Jaho.

Ajo theksoi se: “Ky nder që më bëni sot nuk është thjesht një vlerësim për rrugën time artistike, por një ftesë për të qëndruar më afër vendit tim, për të kontribuar më thellë në jetën kulturore dhe shpirtërore të tij. Është një përgjegjësi që e marr me përkushtim të plotë dhe me një ndjeshmëri që nuk është venitur asnjëherë, pavarësisht nga largësitë gjeografike.”



Sopranoja e shquar, Ermonela Jaho, u shpreh më tej e emocionuar që “ky vlerësim vjen nga një institucion që përfaqëson mendimin, dijen, kujtesën dhe vizionin e kombit tonë: prandaj ka një peshë të veçantë për mua, sepse më lidh me një traditë që dua ta nderoj dhe ta pasuroj me gjithçka që jam.”

Në fund, ajo tha se: "E marr këtë vlerësim si një frymëzim për të ecur më tej, për të mos ndalur së kontribuari jo vetëm si artiste, por si shqiptare që beson në fuqinë transformuese të kulturës, në domosdoshmërinë e dialogut dhe në përgjegjësinë për ta çuar përpara trashëgiminë tonë të përbashkët.”

Certifikata “Anëtare e jashtme” e Akademisë së Shkencave iu dorëzua sopranos Ermonela Jaho nga znj. Evis Kushi. Ajo lexoi motivacionin e pranimit të Ermonela Jahos si anëtare e jashtme e ASHSH-së. Nëpërmjet kësaj certifikate, Ermonela Jaho vlerësohet si personalitet i artit, këngëtare lirike, soprano me njohje ndërkombëtare. Znj. Kushi shprehu mirënjohjen e thellë për përkushtimin artistik dhe kënaqësinë e krenarinë që na

jep sopranoja shqiptare me arritjet e saj në skenat botërore.



Gjatë takimit të pranishmit ndanë mendime dhe emocione tepër miqësore me sopranon e madhe.

Fotot: Roland Tasho

www.akad.gov.al

Akademik Shaban Sinani nderohet me çmimin prestigjioz "Sami Frashëri" nga Bashkia e Belshit

Akademik Shaban Sinani, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, u vlerësua sot, më 19 shtator 2025, me çmimin vjetor "Sami Frashëri".

Çmimi, i mbështetur mbi një vendim të Këshillit Bashkiak të Belshit, iu akordua akad. Sinanit nga juria, e përbërë nga personalitete të njohura të botës akademike dhe kulturore: akad. Gëzim Hoxha (AShSh); studiuesi Behar Gjoka; muzikologu Naim Gjoshi; studiuesja Viola Isufaj dhe kryetari i jurisë, z. Namik Dokle.



Çmimi "Sami Frashëri" për "Studime albanologjike" iu dha akad. Shaban Sinanit për veprën "Studime antropologjike në etnokulturë" me motivacionin: Për kontribut madhor në fushën e shkencave humane shqiptare, me qasje ndërdisiplinore që ndërthur antropologjinë kulturore, etnologjinë, historinë e ideve dhe letërsinë, duke ofruar një tablo të re mbi identitetin shqiptar dhe ndërveprimet e tij me hapësirën ballkanike dhe europiane."

Me këtë rast, akad. Sinani tha se: "Ky çmim është një inkurajim për të gjithë ata që besojnë se identiteti shqiptar është një mozaik i thellë kulturor, që meriton të studiohet me përkushtim. Falënderoj jurinë dhe Bashkinë e Belshit për këtë vlerësim që nderon punën shkencore në fushën e albanologjisë."

www.akad.gov.al

Të reja

Zbulohet një varr monumental i periudhës romake në fshatin Strikcan të Bulqizës

- Zbulimi u bë gjatë punimeve arkeologjike të kryera në kuadër të projektit kërkimor-shkencor të Institutit të Arkeologjisë, pjesë e Akademisë së Shkencave: “Kërkime arkeologjike në Luginën e Bulqizës”.



Projekti drejtohet nga akad. Adem Bunguri dhe msc.Erikson Nikolli.

Zbulohet një varr monumental I periudhes romake i pari I llojit të tij në Shqipëri. Në fshatin Strikcan të Bulqizës gjatë punimeve arkeologjike të kryera në kuadër të projektit kërkimor-shkencor “Kërkime Arkeologjike në Luginën e Bulqizës”, drejtuar nga Akad.Adem Bunguri dhe Msc.Erikson Nikolli ka dalë në dritë një varr monumental unikal, me dimensione të mëdha rreth 9 m x 6 m dhe dhoma funerare 2.40 m e lartë. Ky monument përvec arkitekturës të vecantë përmbante dhe të dhëna të rëndësishme arkeologjike dhe epigrafike, ku për herë të parë zbulohet një mbishkrim romak në zonën e Dibrës, bilingual, i cili i kushtohet individit të varrosur në këtë varr, i quajtur Gelliano, si dhe një dedikim drejtuar perëndisë më të rëndësishme romake Jupiterit. Varri edhe pse i grabitur që në periudhën e lashtësisë por dhe më pas, përmbante një pjesë të inventarit I cili përbëhej nga enë qelqi të tipologjive të ndryshme, krehër kocke, thika dhe ruhej një pjesë e madhe e tekstilit e thurur me fije ari, me të cilin individit ka

qenë varrosur.



Varri është ideuar në tre ambiente: dhoma e varrimit, paradhoma dhe shkallarja monumentale. Muret e shkallares kanë qenë të dekoruara me motive gjeometrike në stuko të cilat ruhen ende. Përvec pjesës nëntokësore funerare, arkeologët kanë evdientuar struktura muresh në pjesën e sipërme të varrit, të cilat sugjerojnë që ky monument mund të ketë qenë i tipit mausoleum. Zbulimet nuk ndalen këtu, por në afërsi të varrit monumental është zbuluar dhe një tjetër mbishkrim funerar i cili pritët te analizohet më tej për shkak të gjendjes së dëmtuar të tij. Materiali ndërtimor kryesisht përbëhet nga gurë të përmasave të mëdha të punuara në trajtë kornizash të cilat janë marrë nga gurore larg lokalitetit në fjalë. Inventari, teknika e ndërtimit si dhe të dhënat epigrafike e datojnë këtë monument unikal në shekujt III-IV e.s. Pritët që zbulimet e mëtejshme të nxjerrin të dhëna të reja të cilat do të pasurojnë hartën arkeologjike të prapaktokës së territorit tonë.

www.akad.gov.al

Një studim gjithëpërfshirës mbi gatishmërinë teknologjike në sektorin e mikpritjes shqiptare sapo është publikuar në revistën shkencore ndërkombëtare *Tourism and Hospitality (MDPI)*, e renditur me faktor impakti 3.7, ndër më të lartët në fushën e turizmit dhe mikpritjes

Akademia e Shkencave përgëzon anëtarin e saj akademik Kozeta Sevrani, institucionet dhe partnerët e përfshirë për këtë arritje të spikatur, e cila jo vetëm i shërben kërkimit shkencor, por edhe krijon ura të reja bashkëpunimi midis politikës publike, industrisë dhe universiteteve.

Ky studim, i cili përfshin 1821 struktura të licencuara hoteliere dhe akomoduese në Shqipëri, përfaqëson kontributin më të madh empiriko-statistikor deri më sot tek ne mbi këtë tematikë. Rezultatet e tij ndikojnë jo vetëm në imazhin ndërkombëtar të turizmit shqiptar, por edhe në politikëbërje, strategji investimi dhe ndërveprime akademiko-industriale në nivel rajonal dhe global.

Punimi është rezultat i një partneriteti ndërinstitucional mes Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, INSTAT, AKKSHI dhe aktorëve të industrisë, duke demonstruar se ndërthurja e akademisë, shtetit dhe biznesit mund të prodhojë evidenca të matshme e të dobishme për zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë ndërkombëtare.

Strategic Readiness for AI and Smart Technology Adoption in Emerging Hospitality Markets: A Tri-Lens Assessment of Barriers, Benefits, and Segments in Albania

by **Majlinda Godolja** * , **Tea Tavanxhiu**  and **Kozeta Sevrani** 

Faculty of Economy, University of Tirana, 1010 Tirana,
Albania

* Author to whom correspondence should be addressed.

Gjetjet kryesore dhe treguesit analitikë:

Vetëm 37.2% e strukturave përdorin sisteme të menaxhimit hotelier (PMS), duke treguar një hendek të madh në digjitalizimin bazë të sektorit.

Më pak se 10% aplikojnë teknologji të avancuara, si chatbotë, revenue management ose sisteme inteligjente të automatizimit.

75% e të anketuarve i perceptojnë teknologjitë smart si mjete që rrisin efikasitetin operacional, kursimin e energjisë dhe cilësinë e përvojës së klientit.

Analiza tipologjike e bizneseve nxjerr tre grupe kryesore:

- ◆ Liderë Teknologjikë (17.7%) – përqafues aktivë të inovacionit.
- ◆ Përdorues Selektivë (43.5%) – të kufizuar në përdorime të pjesshme.
- ◆ Skeptikë (38.8%) – me rezistencë ndaj transformimit digjital.

Këto tregues dëshmojnë nevojën e lartë për penetrim teknologjik, por edhe polarizim të dukshëm midis pionierëve dhe pjesës konservatore të industrisë, çka ka pasoja të drejtpërdrejta mbi konkurrueshmërinë rajonale dhe ndërkombëtare.

Aktualisht, është në zhvillim faza e dytë e studimit, e fokusuar në pritshmëritë dhe përvojën e klientëve ndaj teknologjive smart. Kjo pritet të furnizojë politikëbërësit dhe industrinë me të dhëna të vlefshme për përputhjen e shërbimeve shqiptare me standardet ndërkombëtare të turizmit të digjitalizuar dhe të qëndrueshëm.

📖 Studimi i plotë mund të konsultohet këtu:

👉 <https://www.mdpi.com/2673-5768/6/4/187>

www.akad.gov.al

Revista “Studime për artin”, organi shkencor i Qendrës së Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, është indeksuar në Central and Eastern European Online Library (CEEOL)



Studiesi Stefan Çapaliku përmes një komunikimi publik ka njoftuar se “Studime për artin” tashmë është indeksuar në Central and Eastern European Online Library (CEEOL).

Kemi kënaqësinë të ndajmë lajmin se revista “Studime për artin” tashmë është indeksuar në Central and Eastern European Online Library (CEEOL): <https://www.ceeol.com/search/journal-detail?id=4446>.

“Studime për artin”, që sivjet feston 30-vjetorin e botimit, është organi shkencor i Qendrës së Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe njëherazi periodiku më i rëndësishëm shkencor kushtuar çështjeve që kanë të bëjnë me teorinë, praktikën dhe historinë e artit në Shqipëri. CEEOL është një ndër burimet kryesore të literaturës shkencore nga dhe mbi Evropën Qendrore, Lindore e Juglindore në lëmin e shkencave humane dhe sociale. Databaza e CEEOL numëron mijëra tituj, ku përfshihen, krahas revistave elektronike, edhe librat elektronikë si dhe dokumente të së ashtuquajturës “literaturë gri”. Indeksi në CEEOL do t’i sjellë një dukshmëri më të madhe revistës “Studime për artin” dhe veprimtarive kërkimore të Qendrës së Studimit të Arteve.

www.akad.gov.al

Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore – Një udhëtim i gjallë nëpër kohë

Më 29 shtator, në Muzeun Arkeologjik të Akademisë së Shkencave, u zhvillua një aktivitet i veçantë në kuadër të Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore. Kjo ditë u konceptua si një përvojë e gjallë, ku nxënësit e shkollave “Protagonistët” dhe “Asim Vokshi” u bënë bartës të dijes dhe përcjellës të trashëgimisë, duke u dhënë frymë objekteve muzeale përmes kuriozitetit dhe krijimtarisë së tyre. Aktiviteti ngjalli interes të jashtëzakonshëm dhe u ndoq me entuziazëm nga vizitorë të shumtë, mësues, prindër, studiues dhe të apasionuar pas trashëgimisë kulturore, duke krijuar një atmosferë të gjallë, plot energji dhe përfshirje.



Aktiviteti filloi në orën 11:00 me ceremoninë e hapjes, ku fjalët përshëndetëse u mbajtën nga:

Dr. Melsi Labi, Përgjegjës i Muzeut Arkeologjik, i cili e përshkroi muzeun si një klasë të hapur, ku nxënësit mësojnë përmes përvojës dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me historinë.

Akad. Adem Bunguri, Drejtor i Institutit të Arkeologjisë, që solli në vëmendje vlerat shkencore dhe kulturore të objekteve të ekspozuara, si dëshmi të identitetit tonë kombëtar.



Ma. Gema Kraja, Përgjegjëse e Ekspozitës, e cila ndau me të pranishmit filozofinë kuratoriale që e bën trashëgiminë të komunikueshme dhe të prekshme për brezat e rinj.

Pas ceremonisë, vizitorët u përfshinë në guida të shoqëruara nëpër pesë sallat kryesore të muzeut, duke zbuluar 2,094 objekte autentike që flasin për jetën, zakonet, luftërat, besimet dhe artin e paraardhësve tanë.

Muzeu u shndërrua në një laborator kreativ ku nxënësit u angazhuan në veprimtari ndërvepruese si:

🗨️ Kuizi i Trashëgimisë – një sfidë e dijes dhe kuriozitetit

✂️ Hero për një Moment – foto me replikën e shpatës ilire, si kujtim simbolik

✉️ Letër për një Objekt – letra imagjinare që i japin zë objekteve muzeale

🎨 Skica të Trashëgimisë – vizatime të realizuara në kohë reale nga nxënësit e artit

Si përfundim, u hap ekspozita e skicave të realizuara gjatë ditës, si një reflektim vizual mbi përvojën e përbashkët. Aktiviteti u mbyll me falenderime për të gjithë pjesëmarrësit.

📖 Hyrja në muze ishte falas gjatë gjithë ditës, një ftesë e hapur për të gjithë ata që duan të lidhen me rrënjët kulturore.

Ky aktivitet nuk ishte thjesht një vizitë, ishte një udhëtim në kohë, një përvojë që i dha zë historisë, i dha ngjyrë kujtesës dhe u dha shpirt objekteve të heshtura. Të rinjtë u bënë jo vetëm vizitorë, por edhe krijues, dëshmitarë dhe mbartës të trashëgimisë sonë.

In memoriam

Akademia e Shkencave kujton me nderim në 115-vjetorin e lindjes akademikun Aleks Buda



Sot, në 115 - vjetorin e lindjes, përkujtojmë me nderim akademikun Aleks Buda, një ndër personalitetet kryesore të shkencës shqiptare.

Ai ishte kryetari i parë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në vitet (1972-1993).

Lindi në Elbasan në një familje të njohur intelektuale. Studimet e larta i kreu në Fakultetin e Filozofisë (dega filozofi-letërsi) të Universitetit të Vjenës (1929-1935). Në vitet (1939-1943) punoi si mësues në Liceun e Tiranës e në atë të Korçës.

Mori pjesë në Lëvizjen Antifashiste Nacional Çlirimtare, duke u zgjedhur më 1944 si nënkryetar i Këshillit ANÇ të qarkut të Elbasanit.

Në vitet 1945-1946 qe drejtor i Bibliotekës Kombëtare. Me formimin më 1955 të Institutit të Historisë e të Gjuhësisë, Aleks Buda u shqua si një ndër organizatorët dhe punonjësit shkencorë më me përvojë të institutit. Buda themeloi sektorin e historisë së mesjetës dhe me këtë hodhi bazat e medievistikës shqiptare. Punoi veçanërisht për përgatitjen e historianëve të rinj e sidomos të studiuesve të historisë mesjetare të Shqipërisë. Si kryetar i ASHSH që në themelimin e saj (1972) dhe si studiues me formim e kulturë të gjithanëshme, historike gjuhësore, arkeologjike, etnografike, të artit mesjetar

etj., Aleks Buda dha një kontribut të çmuar duke vendosur një gurë themeli në fushën e albanologjisë.

Ka marrë “Çmimin e Republikës” të shkallës së parë, është dekoruar me “Urdhërin e Lirisë” të klasit të parë dhe me “Urdhërin e Flamurit të Punës”. Presidenti i Republikës së Austrisë e ka dekoruar më “Medaljen e Madhe të Artë” (1990).

Për më tepër lexo linkun:

<https://akad.gov.al/akademik-aleks-buda/>

www.akad.gov.al

Akademia e Shkencave kujton me nderim akademik Odhise Paskalin



Si sot, dyzet vjet më parë, u nda nga jeta, skulptori i shquar akademik Odhise Paskali.

Odhise Paskali lindi në Përmet, në dhjetor të vitit 1903. Ai është një nga themeluesit e skulpturës shqiptare dhe një nga personalitetet më të rëndësishme të artit shqiptar.

Në vitin 1919 ai shkoi në Itali dhe në vitin 1923 kreu Liceun dhe u regjistrua në Fakultetin e Letërsisë e të Filozofisë në Torino, ku më 1927 mbrojti diplomën në fushën e letërsisë dhe historisë së artit. Më vonë, në 1931 krijoi shoqërinë “Miq të artit”.

Në periudhën 1932-1937, në disa qytete të Shqipërisë, u ngritën disa monumente skulpturore, punime të autorit.

Ai u bë nismëtar për krijimin e shoqërisë “Studenti shqiptar” në Torino dhe për botimin e revistës së studentëve shqiptarë të atjeshëm në vitet ‘20.

Në vitet ‘30 u bë nismëtar i shoqatës “Miq të Arbrit”, e cila ishte organizatorja e së parës ekspozitë të arteve figurative dhe të çeljes së Shkollës së Vizatimit në Tiranë.

Rreth viteve 20-30, Odhise Paskali e nisi karrierën në fushën e publicistikës. Ai u shqua në estetikë dhe kritikë arti.

Punimet në skulpturë i nisi sapo mbaroi fakultetin dhe studimet për artin pranë ateliesë së një skulptori italian realist e monumentalist të Torinos. Kështu ai bëhet skulptori i parë profesionist shqiptar.

Me pushtimin fashist të vendit, Odhisea si erudit në fushën e artit, caktohet anëtar i Institutit të Studimeve të atëhershme, por në mungesë edhe të porosive të mjaftueshme, për ngritje shtatoresh, detyrohet të çelë një punishte për përgatitje

shkumësash për nevojat e shkollave të vendit.

Pas çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë, krahas vazhdimit të krijimeve skulpturore për figurat e rilindasve, në tematikën e punimeve të tij zënë vend edhe heronjtë e popullit dhe dëshmorët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.



Edhe pse Odhisea jetoj në Përmet vetëm 14 vjet dhe shumicën e jetës 82-vjeçare e kaloi në Itali dhe në Tiranë, ai ishte i lidhur me vendlindjen.

Ai krijoi në vendlindje një sërë veprash, midis të cilave skulpturën e “Partizantit Çlirimtar”, punën e grupit skulpturor “Shokët” në varrezat e dëshmorëve të Përmetit; bustin e Naimit; të Nonda Bulkës dhe të Fanjo Çiçakos në qytet; bustet e vëllezërve Frashëri në sheshin para Shtëpisë Muze në Frashër, etj.

U shqua për vepra me karakter dhe të veçanta, për cilësi shprehëse që mbizotëronin me një gjenialitet të rrallë materialet e ngurta, duke i bërë ato aq bukur “të lexueshme” nga sytë e njerëzve.

Ai është bashkautor i Monumentit të Skënderbeut në Tiranë; autor i bustit të Skënderbeut, bashkautor i Monumentit të Pavarësisë në Vlorë, si dhe autor i dhjetëra busteve dhe monumenteve të personaliteve të shquara kombëtare dhe të rilindësve.

Ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave, i pari për shumë vite nga fusha e arteve, dhe ndër të parët artistë që mori titullin e lartë “Skulptor i Popullit”.

www.akad.gov.al

Pashko Vasa, dy shekuj më vonë

-Në 200-vjetorin e lindjes-

Nga Virion Graçi

Në secilin nga lëmenjtë e jetës sonë shpirtërore dhe intelektuale: te historia, te etnografia/folklori, te gjuha e letërsia shqipe, emri dhe produkti krijues-historik-dituror i Pashko Vasës është objekt pune e frymëzimi, model dhe monument, njëkohësisht. Meritat e tij si shtetar, si çlirimtar krah njerëzve që synonin liri, pavarësi e përparim e theksojnë edhe më shumë rolin e tij në kohë, në histori, deri në ditët tona: të gjithë kanë çfarë mësojnë prej shembullit të Tij.



Nga këndi i sotëm i shikimit, Pashko Vasa shquhet së pari si figurë qendrore e Rilindjes Kombëtare, ideolog e veprimtar i lëvizjes shpëtimtare për fatin e Shqipërisë e të shqiptarëve, në periudhën kritike kur perandori multietike po shpërbëheshin, po krijoheshin shtetet kombëtare dhe po luhej për jetë a vdekje fati i popujve si ne, numerikisht të vegjël, të ndarë prej shekujsh në qendra të ndryshme administrimi vendor dhe me përkatësi të ndryshme fetare.

Pashko Vasa u identifikua menjëherë me etninë e tij, u bë korife i shqiptarizms që do të ishte formulë bashkimi, mbijetese e shprese.

Shkruan Mit'hat Frashëri për periudhën e Lidhjes së Prizrenit: "Në Kostandinopojë ishte krijuar për të përhapur kulturën e famshme "Shoqëria letrare", në

statutet e të cilës, të publikuara më 1879 shohim si figuronte roli i anëtarëve të saj kryesorë, si të krishterë ashtu dhe myslimanë, më aktivët: Sami bej Frashëri (vëlla i Abdyl bej Frashërit), mysliman, Efendiu Pashko Vasa (katolik nga Shkodra), Jani Vreto, ortodoks i Shqipërisë së jugut, i distriktit të Leskovikut.... Shoqëria e Konstandinopojës nxori po në vitin e themelimit të saj një abece dhe një abetare... Pak kohë më pas Pashko Vasa publikoi veprën e tij të titulluar “Studim për Shqipërinë dhe shqiptarët”, vepër e cila u botua gjithashtu po atë vit në Paris dhe në përkthimin gjermanisht në Berlin; një përkthim në turqisht u bë nga Ali Danish bej Prishtina, anëtar i shoqërisë letrare por sulltani i sekuestroi të gjithë kopjet dhe libri u ndalua.”

Krahas veprimtarive e projekteve të përbashkëta idealiste-atdhetare, për zgjimin, iluminimin dhe organizimin e mbrojtjes së shqiptarëve, do të veçonim prej trashëgimisë letrare të Pashko Vasës poemthin e tij “O moj Shqypni”. Në periudhën tonë shtetërore, ajo ka qenë pjesë e formimit dhe edukimit të disa breznive në shkollat shqiptare; ka qenë pjesë e teksteve të zgjedhura për edukatë letrare, për vetëdije shoqërore e qytetare, krahas pjesëve si “Kthimi i Gjergj Kastriotit në Krujë” apo poezive të muzikuara “Për mëmëdhenë” dhe “E dua më shumë Shqipërinë” të grupit “Lira”. Këto u bënë të qenësishme, të përditshme, në luftë e në paqe po aq sa dhe vetë “Himni i flamurit”, për shkak të përmbajtjes e të porositë që përçon me gjuhë të thjeshtë artistike e vrull orteku. Në periudhën para pavarësisë, kur po kristalizohej vetëdija jonë kombëtare, poemthi “O moj Shqypni” luajti rolin e një besëlidhjeje shpirtërore, kulturore-politike, për masat popullore, kudo ku flitej e mendohej shqip. Ky poemth ishte jo më pak ndikues, proverbial e largpamës se teksti i Sami bej Frashërit “Shqipëria çka qenë, ç’është e çdo të bëhet”. “O moj Shqypni”, krahas “Istori e Skënderbeut” të shkruar nga Naim bej Frashëri, mysliman, si dhe traktati i sipërpërmendur i Samiut, krijuan një trini të shenjtë njësimi e emancipimi, shqiptarizmi, ku e gjenin veten në harmoni përkatësitë fetare dhe orientimi social-politik ishte drejt kulturës dhe qytetërimit europian-perëndimor.


Duke i mbyllur këto radhë nderimi, në ditën e tij të lindjes, nuk mund të lëmë mënjanë faktin se Pashko Vasa, krahas posteve, titujve e dekorimeve të larta që pati, krahas vendit të palëkundshëm në radhën e parë të ideologëve shqiptarë, meritoi që në të gjallë të tij epitelin Shkodrani; u thirr Shkodrani, jo vetëm si mbiemër i dytë për arsye orientimi gjeografik, por si titull fisnikërie, epitet-emblemë shekullore e qytetit të tij: simbol dijeje, trimërie, kulture e atdhetarizmi. Kështu, në sinonimi, Pashko Vasa dhe Shkodra do të nënkuptojnë njëri-tjetrin edhe më tutje, në ardhmëri.

17 shtator 2025

www.akad.gov.al

Akademia e Shkencave kujton me nderim akademik Mahir Domin

Sot është 25 vjetori i largimit nga jeta i gjuhëtarit të shquar, i akademikut Mahir Domi.



Në vijim po hedhim një material të përgatitur nga prof. Seit Mansaku dhe prof. Enver Hysa, botuar në "Fjalorin enciklopedik shqiptar" (FESH), Tiranë, 2008.


MAHIR DOMI (1915-2000). Gjuhëtar, profesor, akademik, Mësues i Popullit. Lindi në Elbasan. Studimet e mesme i nisi në Normalen e Elbasanit dhe i vazhdoi e përfundoi në Liceun Kombëtar (francez) të Korçës (1937). Ndoqi studimet e larta për filologji klasike dhe u diplomua në Universitetin e Grenoblës (Francë) më 1941. Po atë vit filloi punën si mësues e më pas si drejtor në Shkollën Normale të Elbasanit. Që nga viti 1947 punonjës në Institutin e Shkencave, njëkohësisht pedagog në Institutin e Lartë Pedagogjik. Mori pjesë në hartimin e "Fjalorit të gjuhës shqipe" (1954, shih). Me themelimin e UT u caktua përgjegjës i katedrës së gjuhës shqipe (1957-1962) dhe i sektorit të gramatikës e dialektologjisë në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë (1957-1991). Ka dhënë lëndët sintaksa e gjuhës shqipe, morfologjia historike e shqipes dhe historia e albanologjisë. Është një ndër anëtarët themelues të ASHSH dhe anëtar i Presidiumit të saj. Veprimtaria shkencore e Mahir Domit shtrihet në shumë fusha të shkencave filologjike: në gramatikë (sintaksë e morfologji), histori e gjuhës, histori e

albanologjisë, dialektologji e onomastikë, gjuhësi normative dhe kulturë e gjuhës, kritikë shkencore, histori e letërsisë etj. Mahir Domi drejtoi punën për ngritjen e kartotekës së gramatikës dhe për hartimin e veprës "Gramatika e gjuhës shqipe" (në dy vëllime, shih); është kryeredaktor i saj, redaktor e bashkautor i vëll. II "Sintaksa". Ka hartuar tekstet universitare "Morfologjia historike e shqipes" (1961) dhe "Sintaksa e gjuhës shqipe", pjesa I (1968), pjesa II (1969). Ka shkruar dhe një varg artikujsh dhe studimesh sintaksore për çështje të përgjithshme të sintaksës së shqipes dhe të zhvillimit të strukturës së saj, si për njësitë sintaksore (fjalë, periudha, togfjalëshi, gjymtyrët e fjalisë, për llojet e raporteve sintaksore dhe mjetet e shprehjes së tyre, për sintaksën e tekstit, për gjymtyrët homogjene, fjalët e grupet e fjalëve gramatikusht të palidhura me gjymtyrët e fjalisë, gjymtyrët e veçuara, për fjalitë e pazbërthyeshme e fjalitë mungesore etj. Në fushën e historisë së gjuhës ka shkruar disa artikuj e referate për problemin e origjinës së gjuhës shqipe dhe për çështje të marrëdhënieve të gjuhës shqipe me gjuhë të Ballkanit, sidomos me rumanishten, si: "Prapashtesa ilire dhe shqipe, përkime dhe paralelizma" (1974), "Konsiderata mbi tiparet e përbashkëta të shqipes me gjuhët ballkanike dhe mbi studimin e tyre" (1975), "Mbi disa përkime dhe paralelizma sintaksore shqipe-rumune" (1977), "Probleme të historisë së formimit të gjuhës shqipe, arritje dhe detyra" (1982). Mahir Domi ka dhënë kontribute të shumta për historinë e gjuhës së shkruar në përgjithësi, për fillimet e shkrimit të gjuhës shqipe e tekstet e vjetra shqipe, për probleme të shqipes letrare gjatë Rilindjes, për gjuhën standarde, për kulturën e gjuhës. Ka qenë anëtar i komisioneve për hartimin e projekteve të drejtshkrimit (1956, 1967) dhe të veprave "Drejtshkrimi i gjuhës shqipe" (1973), "Fjalori drejtshkrimor" (1976), "Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe" (1981, 2002). Anëtar i komisionit organizues dhe delegat i Kongresit të Drejtshkrimit (1972, shih). Ka marrë pjesë në komisionet hartuese të një vargu fjalorësh terminologjikë, ndër të cilët edhe "Fjalori i termave të gjuhësisë" (1975). Mahir Domi organizoi dhe drejtoi përshkrimin e studimin tërësor të të folmeve të shqipes nëpërmjet skicash të thjeshta, monografish e studimesh përgjithësuese, për të arritur deri te "Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe" (shih); themloi dhe drejtoi përmbledhjen "Dialektologjia shqiptare" (shih); ishte gjithashtu nismëtar i mbledhjes së lëndës onomastike dhe i themelimit të një kartoteke të veçantë, bashkautor i pyetësorit për mbledhjen e toponimisë dhe autor i disa artikujve nga kjo fushë.

Mahir Domi është autor i pjesës për letërsinë e vjetër shqiptare dhe letërsinë me alfabet arab në veprën "Historia e letërsisë shqipe", vëll. I (1959), botim i UT, si dhe një ndër redaktorët e veprës "Historia e letërsisë shqiptare" (1983), botim i ASHSH. Si autor i një vargu recensionesh ka sjellë ndihmesë në zhvillimin e kritikës shkencore, duke i hapur rrugën hartimit të një historie të mendimit gjuhësor shqiptar. Me tekstet e

sintaksës dhe të letërsisë së huaj Mahir Domi ka dhënë ndihmesë edhe për arsimin e përgjithshëm. Ka marrë Çmimin e Republikës të shkallës së parë (dy herë).

**I trishtë lajmi për ndarjen nga jeta të mjeshtrit të kinematografisë shqiptare,
"Nderi i Kombit" Dhimitër Anagnosti!**



Operator, regjisor, skenarist-Artist i Popullit. Lindi në Vuno të Himarës në rrethin e Vlorës më 23 janar 1936. U diplomua në Institutin Kinematografik "VGIK" të Moskës për kinooperator. Filloi punën në kinostudion "Shqipëria e re" (1961) si kinooperator në filmat "Debatik" dhe "Toka e jonë" (1964) si dhe në xhirimin e filmave dokumentarë "Gjirokastra" dhe "Gurët dekorative". Në filmin e parë artistik "Komisari i dritës" (1966), ish bashkautor në regji dhe kamera me V. Gjikën, një film ky që pati jehonë në publik, u nderua me Urdhrin "Naim Frashëri". Filmi i tij i parë si regjisor i pavarur ishte "Duel i heshtur" (1967), ku dolën në pah përpjekjet e suksesshme të regjisorit për të depërtuar në psikologjinë e njeriut. Më vonë Anagnosti xhirooi disa filma që tërhoqën vëmendjen e qarqeve të ndryshme për një stil të veçantë dhe gjuhë të pastër filmike si: "Plagë të vjetra" (1969), "Malet me blerim mbuluar" (1971), por filmi i tij që pati një sukses të padiskutueshëm dhe që shënoi një pikë kulmore në krijimtarinë e tij ishte "Lulëkuqet mbi mure" (1976). Ky film u nderua me disa çmime kombëtare dhe ndërkombëtare, konsiderohet si një nga veprat më të arrira të kinematografisë shqiptare. Një sukses të bujshëm patën edhe filmat "Përrallë nga e kaluara" (1987) dhe "Kthimi i ushtrisë së vdekur" (1989) në të cilët, është edhe autor i skenarit. Për disa vjet

ai ka punuar edhe si skenarist dhe redaktor në redaksinë e filmit artistik. Është autor i 11 skenarëve. Veprat e Anagnostit janë nderuar me tre Çmime të Republikës (1969,1979,1983), tre Çmime Ndërkombëtare (1980,1983,1985), nga të cilët një Çmim të Madh "GRAND PRIX" dhe një "Medalje ari". Eshtë fitues i tri Kupave të Festivaleve të Filmit Shqiptar si dhe të Çmimit "Aleksandër Moisiu"(1989). Ka fituar gjithashtu disa çmime për skenarët. Më 1987 iu dha titulli "Artist i Popullit". Në mars 1991 ai u zgjodh Deputet si kandidat i Partisë Demokratike në Parlamentin e parë pluralist shqiptar. Në Maj 1992 u emërua Ministër i Kulturës Rinisë dhe Sporteve. Ka drejtuar për disa vite Fondacionin "Fan S. Noli" për Kulturën dhe Artin. Në Festivalin e 10-të të Filmit Shqiptar (10-13 Maj, 1995) u nderua me "Çmimin e Karrierës". Në vitin 2001 shkroi, dhe vuri në skenë në Teatrin Kombëtar dramën e vetme "Nata e trokitjeve në xham". Ndërsa në vitin 2005 korri sukses me filmin e tij më të fundit "Gjoleka, djali i Abazit", film i nderuar me dy çmime ndërkombëtare në Itali.

Lamtumirë Mjeshtër!

www.akad.gov.al

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Vasil S. Tole, dhe kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike, akademik Gëzim Hoxha, bëjnë homazhe në nderim të regjisorit të shquar, personalitetit të kulturës shqiptare Dhimitër Anagnosti

Dhimitër Anagnosti është vlerësuar me titullin “Nderi i Akademisë” në vitin 2022 me motivacionin “Autor veprash origjinale kinematografike si regjisor, skenarist e operator; themelvënës në historinë e artit filmik shqiptar dhe me një vend qendror në gjithë trashëgiminë e tij, që arriti të ndërthurë mjeshtërisht botën shqiptare tradicionale në një art të ri të zhvilluar në kohë të vështira dhe e paraqiti atë me cilësi konkurruese në mjediset europiane; shkrimtar e publicist; personalitet me veprimtari të shquar në jetën publike”.

Akademia e Shkencave ka botuar gjithashtu monografinë kushtuar Dhimitër Anagnostit me autor prof. Josif Papagjonin.

www.akad.gov.al

Ndahet nga jeta dr. Agim Bido, studiues i shquar i etnografisë shqiptare



Akademia e Shkencave, Instituti i Antropologjisë, mësuan me hidhërim të thellë, se pas një sëmundjeje të rëndë u nda nga jeta dr. Agim Bido (1956-2025), etnograf, ish punonjës kërkimor shkencor i Institutit të Folklorit, sot Instituti i Antropologjisë pranë Akademisë së Shkencave.

Lindi më 8 gusht 1956 në qytetin e Delvinës. Në vitin 1982 përfundon studimet për pikturë në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë dhe prej vitit 1983, punoi si kërkues shkencor pranë Institutit të Folklorit.

Agim Bido ishte studiues dhe etnograf i shquar shqiptar, i cili ia kushtoi gjithë jetën e Tij dokumentimit dhe ruajtjes së trashëgimisë sonë kulturore. Autor i veprës së rëndësishme “Arti popullor në veshje e tekstile popullore” (1991), Bido la një kontribut të rëndësishëm në studimin e kostumeve tradicionale shqiptare, veçanërisht të xhubletës, simbolit të rrallë të kulturës sonë kombëtare për të cilën ai është shprehur se Xhubleta shqiptare, është enciklopedi kulturore e gjallë. Kontributi i tij studimor ishte thelbësor në regjistrimin e xhubletës si pjesë e Listës Përfaqësuese të Trashëgimisë

Jomateriale të UNESCO-s.

Shih <https://ich.unesco.org/.../xhubleta-skills-craftsmanship...>

Trashëgimia kërkimore shkencore e dr. Bidos, përveç monografive përfshin mbi treqind shkrime në revista të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit, duke mbetur një thesar i pazëvendësueshëm në këtë fushë. Jeta, puna dhe pasioni i dr. Bidos për historinë, artin popullor dhe etnografinë shqiptare do të mbeten një udhërrëfyes i çmuar për studiuesit dhe brezat që vijnë.

Në këtë ditë të nderë, Akademia e Shkencave, Instituti i Antropologjisë shprehim ngushëllimet më të thella për familjen, miqtë dhe kolegët si dhe për botën akademike shqiptare.

I paharruar kolegu ynë!

Tiranë më, 5 shtator 2025

www.akad.gov.al

U nda nga jeta prof. dr. Hëna Pasho

-Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letësisë shprehin ngushëllimet, nderimin e respektin për figurën e dr.Hëna Pashos, për punën dhe trashëgiminë e vyer shkencore që la pas!-



Para pak ditësh u largua nga jeta gjuhëtarja e shquar, prof. dr. Hëna Pasho. Profesorja lindi në Përmet. Kreu shkollën e mesme pedagogjike “17 Nëntori”, Tiranë, dhe më pas studimet e larta në Universitetin e Tiranës, dega Gjuhë shqipe e letërsi, të cilat i përfundoi me rezultate shumë të larta në vitin më 1966. Për 3 vjet punoi si mësuese dhe si drejtuese shkolle në Përmet. Në vitin 1969 fillon punë në Institutin e Gjuhësisë dhe të Historisë, pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës, kurse në vitin 1972 fillon punë në sektorin e terminologjisë pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, ku punon deri në vitin 2009, kur del në pension.

Prof. Hëna Pasho ka qenë një nga studiueset më të spikatura në Albanologji dhe në Institutin e Gjuhësisë deri në kohën që pensionohet, ishte e vetmja femër që mbante titullin “Profesor”. Ajo pati fatin e madh të punonte me akad. Eqrem Çabej, me akad. Mahir Domi, me akad. Androkli Kostallari, me akad. Jani Thomai, dhe me shumë dijetarë të tjerë, si prof. Lirak Dodbiba, prof. Ferdinand Leka, prof. Jorgji Gjinari prof.

Miço Samara të tjerë, nga të cilët mësoi shumë. Ajo punoi në një mjedis pune e në një institucion shkencor elitar dhe aty u rrit dhe u maturua si shkencëtare e denjë.

Prof. Hëna Pasho ishte skrupuloze në punë, korrekte deri në detaje, bashkëpunuese e kërkuese. Ndërttoi marrëdhënie shumë të mira me kolegët dhe dha ndihmesa të çmueshme në shumë drejtime të punës shkencore në Institut. Ajo kreu detyra të ndryshme, si: anëtare dhe sekretare shkencore e Këshillit Shkencor të Institutit, anëtare e redaksisë së revistës “Studime filologjike” dhe përgjegjëse e seksionit të terminologjisë.

Prof. Hëna Pasho, në vitin 1988, ndoqi “Shkollën verore” të Vienës (INFOTERM), pranë Qendrës ndërkombëtare e terminologjisë, duke pasuruar e konsoliduar formimin e vet shkencor.

Fusha saj e ngushtë e studimeve ishte terminografia dhe terminologjia e shkencave shoqërore. Ajo punoi në dhjetëra grupe pune me specialistë e gjuhëtarë për hartimin e 12 fjalorëve terminologjikë normues (shqip-gjuhë të huaja) për disiplinat e ekonomisë, të drejtësisë, të gjeografisë e të anatomisë, që janë vepra kolektive dhe ku ndihmesa e saj si drejtuese dhe si hartuese janë të vlerësuara shkencërisht. Po përmendim këtu vepra, si: Fjalor i termave të ekonomisë politike (shqip-rusisht-frëngjisht), Tiranë, 1983 (b/autore dhe redaktore shkencore kryesore); Fjalor i termave të statistikës (shqip-rusisht-frëngjisht), Tiranë, 1983 (b/autor dhe redaktore shkencore kryesore); Fjalor i termave të financës dhe të kontabilitetit (shqip-rusisht-frëngjisht), Tiranë, 1985 (b/autore dhe redaktore shkencore kryesore); Fjalor i termave të planifikimit (shqip-rusisht-frëngjisht), Tiranë, 1988 (b/autore dhe redaktore shkencore kryesore); Fjalor i termave të tregtisë së brendshme (shqip-frëngjisht-rusisht), Tiranë, 1999 (b/autore dhe redaktore shkencore kryesore); Fjalor i termave të transportit (shqip-anglisht-frëngjisht-rusisht), Tiranë, 2002 (b/autore dhe redaktore shkencore kryesore); Fjalor i termave të gjeografisë (shqip-rusisht-frëngjisht), Tiranë, 1975 (b/autore); Fjalor i termave të anatomisë (shqip-frëngjisht-rusisht), Tiranë, 1986 (b/autore); Fjalor i termave të së drejtës (shqip-frëngjisht-rusisht), Tiranë, 1986 (b/autore); Fjalor i termave të bankës (shqip-frëngjisht-anglisht-italisht-rusisht) (b/autore dhe redaktore shkencore kryesore).

Prof. Hëna Pasho hartoi gjithashtu, dy monografi: “Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe nga Rilindja deri në vitet ’80 të shekullit XX” dhe “Togfjalëshi terminologjik në gjuhën shqipe”.

Edhe pas daljes në pension, ajo nuk i ndërpreu asnjë çast marrëdhëniet me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Në vitin 2017 Instituti botoi përmbledhjen e saj me artikuj “Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe”.

Këta 4 vjetët e fundit ajo dha ndihmesë të çmuar në pasurimin e Korpusit elektronik për Fjalorin e Madh të Gjuhës shqipe (me 125.000 fjalë e që është në proces përfundimi) me terma nga fusha e financës, e ekonomisë, e bankës etj.

Prof. Hëna Pasho ka publikuar mjaft artikuj e studime në revista shkencore brenda e jashtë vendit për probleme të terminologjisë, të lidhjeve të termit me gjuhën letrare apo për vepra të autorëve të ndryshëm etj. Ajo ka marrë pjesë në projektin ndërkombëtar për hartimin e një fjalori shumëgjuhësh me terma të bibliotekës, me cilësinë e konsulentës gjuhësore për termat shqip, projekt i drejtuar nga Research Development Department National and University Library, Ljubljana, Slovenia.

Emri i prof. Hëna Pasho është përfshirë në “International Who’s in Translation Terminology/ Traduction et Terminologie-Répertoire biographique international”, 1995.

Gjithashtu ajo është nderuar me Urdhrin “Naim Frashëri” të klasit III dhe me Medaljen “Për shërbime të shquara shtetërore dhe shoqërore”.

Largimi i prof. Hëna Pasho nga jeta dhe kalimi në amshim krijon një zbrazëti që e ndiejnë jo vetëm të afërmit, por dhe ne ish-kolegët e saj të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë.

Nderim dhe respekt për figurën e saj, për punën e trashëgiminë e vyer shkencore që la pas!

Ndahet nga jeta profesor Mina Naqo, figurë e shquar e matematikës shqiptare dhe personalitet me kontribute të vyera në arsimin dhe shkencën kombëtare



Mina Naqo, lindi më 12 janar 1939, në qytetin e Vlorës. Në shtator të vitit 1955 ai i filloi studimet në Institutin e Lartë Pedagogjik të Tiranës në degën matematikë-fizikë. Ishte student i shkëlqyer.

Në vitin 1959 ai emërohet pedagog në Katedrën e Matematikës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Megjithëse ishte i sapodiplomuar dhe në moshë shumë të re, Minait iu besua dhënia e kursit të leksioneve të analizës matematike në Institutin e Lartë Pedagogjik dyvjeçar në Tiranë. Për Minain filloi një periudhë intensive pune. Në të njëjtën kohë ai zhvillonte linjën e ushtrimeve në analizë dhe algjebër në degët e matematikës dhe të fizikës.

Karriera e tij u lidh ngushtë me Departamentin e Matematikës në Universitetin e Tiranës, ku për dekada me radhë shërbeu jo vetëm si pedagog, por edhe udhëheqës shpirtëror i brezave të rinj. Me qetësinë dhe autoritetin e tij shkencor, ai frymëzoi studentë e kolegë, duke u bërë figurë model për përkushtim, integritet dhe dashuri për dijen.

Si specialist i lëndës së statistikës prof. M. Naqo ka ndërtuar programe dhe ka mbajtur kursin përkatës edhe në universitete të tjera ku është kërkuar. Për ta rritur më

shumë zbatimet e statistikës në praktikë nëpërmjet teknologjive të kohës, ai botoi librin interesant “Hyrje në Statistikë me excel”.

Ai ishte autor dhe bashkautor i teksteve të shumta universitare dhe shkollore, të cilat për vite u shndërruan në bazë të formimit të mijëra nxënësve dhe studentëve shqiptarë. Me punën e tij kërkimore dhe botimet shkencore, ai la gjurmë të çmuara në zhvillimin e matematikës dhe në ngritjen e standardeve akademike në vend.

Me njohuritë e thelluara dhe kreativitetin e tij mbi teorinë e probabiliteteve ai përcaktoi temat e studimit dhe udhëhoqi në përgatitjen e disertacioneve një numër pedagogësh të matematikës në universitet. Ai dha kontribut në Akademinë e Shkencave, si dhe në institucione të tjera.


Prof. Mina Naqo do të mbetet në kujtesën e kolegëve, studentëve dhe miqve të tij si njeri i thjeshtë, i urtë e i përkushtuar, i cili diti të ndërthurte rreptësinë shkencore me humanizmin dhe ngrohtësinë njerëzore.

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe kolegët e Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike pranë saj i shprehin ngushëllimet më të sinqerta familjarëve, kolegëve dhe miqve për ndarjen nga jeta të profesorit të nderuar Mina Naqo!

Qoftë i përjetshëm kujtimi i tij dhe i paharruar kontributi në arsimin dhe shkencën shqiptare!

Lexo linkun: <https://mountpleasantgroup.permavita.com/site/MinaNaqo.html>
www.akad.gov.al

**Ndahet nga jeta aktori i kinemasë e teatrit, pedagogu, dramaturgu e regjisor i z.
Enver Petrovci**



Ndahet nga jeta aktori i kinemasë e teatrit, pedagogu, dramaturgu e regjisor i z. Enver Petrovci. I lindur në vitin 1954 në Prishtinë, ndoqi studimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike në degën e aktrimit dhe më pas në Fakultetin e Arteve Dramatike në Universitetin e Beogradit. Zoti Petrovci ishte i njohur si në Shqipëri, edhe në Kosovë, i vlerësuar me çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndër rolet e tij, përmenden të teatër: "Idioti", "Muslimani", "Dëshmitari kryesor", "Kush më ka faj që jam shqiptar", "Guxim për vrasje" dhe në kinema: "Kur pranvera vonohet", "Lazari", "Rojet e mjegullës", "Forbidden sun", "Migjeni", "Nekrologji", "Lule të kuqe, lule të zeza", "1244", "Një Milion Euro", "Anatema", "Gomarët e Kufirit", etj. Komiteti i Përhershëm i Arteve dhe Qendra e Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u çojnë ngushëllime të sinqerta familjes, të afërmeve, miqve dhe kolegëve! 🕯️🌸

www.akad.gov.al